



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.10.2019, ora 11.00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetarj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2018”.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Vullnet Sinaj, Reme Lala, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Suzana Topi, Krenar Ryci, Ervin Bushati, Evis Kushi, Arben Elezi, Antoneta Dhima, Senida Mesi, Ylli Shehu, Korab Lita, Xhevit Bushaj, Blerina Gjylameti, Sadi Vorpsi dhe Dritan Bici, Eljo Hysko

Mungojnë:

Roland Xhelilaj dhe Anastas Angjeli

Të ftuar:

Elton Haxhi - Zëvendësministër i Financave

Mimoza Dhëmbi – Drejtoreshë e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave

Xhoana Agolli – Drejtoreshë e Buxhetit në Ministrinë e Financave

Alma Beja - Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit në Ministrinë e Financave

Aurela Velo – Drejtoreshë e Biznesit në Ministrinë e Financave

Nikolla Lera - Drejtor i Përgjithshëm i Çështjeve Fiskale në Ministrinë e Financave

Endrit Lami - Drejtor i Çështjeve Makroekonomike në Ministrinë e Financave

Lindita Milo – Drejtoreshë e Përgjithshme e Kontrollit të Lartë të Shtetit

Rinald Muça - Drejtor i Përgjithshëm në Kontrollin e Lartë të Shtetit

Valbona Gaxha - Kryeaudituese në Departamentin e Auditimit të Buxhetit të Shtetit në Kontrollin e Lartë të Shtetit

Kozma Kondakçi - Drejtor i Departamentit të Auditimit të IT-së në Kontrollin e Lartë të Shtetit

Rigels Guzi - Auditues në Kontrollin e Lartë të Shtetit

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Fillojmë mbledhjen.

Sot në rendin e ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2018”.

Kemi të ftuar zëvendësministrin, zotin Elton Haxhi, zonjën Mimoza Dhëmbi, drejtoreshë e Përgjithshme e Buxhetit, zonjën Xhoana Agolli, zotin Nikolla Lera, drejtor i Përgjithshëm i Çështjeve Fiskale, zotin Endrit Lami, drejtor i Çështjeve Makroekonomike, nga KLSH-ja kemi të ftuar zonjën Lindita Milo, drejtoreshë e Përgjithshme, zotin Rinald Muça, drejtor i Përgjithshëm, zonjën Valbona Gaxha, kryeaudituese, zotin Kozma Kondakçi, drejtor i Departamentit të Auditimit të IT-së dhe zotin Rigels Guzi, auditues.

Relatore është zonja Blerina Gjylameti.

Fjalën po ia kaloj relatores, por ndërkohë dua të kërkoj nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë dhe KLSH-ja që të jenë sa më koncizë në fjalët e tyre.

Ju lutem!

Blerina Gjylameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Shqyrtimi i projektligjit “Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2018” është një procedurë e konsoliduar ndër vite, e cila mbështetet në disa nene të Kushtetutës, si nenet 158, 164, neni 63 i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, gjithashtu, në nenin 31 të ligjit nr. 154 të vitit 2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, në ligjin “Për buxhetin 2018”, të ndryshuar” me nr. 109 të vitit 2017, si dhe në ligjin nr. 10296 të vitit 2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Mbështetur në këtë bazë ligjore, Këshilli i Ministrave ka paraqitur në Kuvend projektligjin “Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2018” të shoqëruar me raportin për zbatimin e buxhetit vjetor.

Në këtë raport paraqitet një analizë e hollësishme për zhvillimet makroekonomike gjatë vitit 2018, për politikat fiskale, për rezultatin e mbledhjeve të të ardhurave dhe shpenzimeve, për buxhetin vendor, për menaxhimin e borxhit publik, si dhe për rreziqet fiskale dhe detyrimet kontingjente.

KLSH-ja ka paraqitur raportin për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2018, duke shprehur opinionin e tij për rregullshmërinë e transaksioneve dhe saktësinë e raportimeve, që kanë të bëjnë me zbatimin e buxhetit, me përdorimin e fondit rezervë të Këshillit të Ministrave dhe fondet e kontingjencës, me raportimin e borxhit publik, funksionimin e sistemeve të menaxhimeve financiare dhe kontrollit dhe me organizimin e funksionimit të auditimit të brendshëm në sektorin publik. Ky opinion bazohet në gjetjet dhe rekomandimet e auditimeve të kryera nga KLSH-ja në institucionet e qeverisjes vendore, qendrore dhe entitetet e tjera publike.

Në këtë raport KLSH-ja pasqyron masat dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

Buxheti i vitit 2018 u ndryshua me dy akte normative të Këshillit të Ministrave si më poshtë:

Me aktin normativ nr. 1 , të datës 26.07.2018, i cili nuk preku treguesit kryesorë makroekonomik të parashikuar në fillim të vitit, përbëri disa rialokime, për të siguruar dhëniet e shpërblimit të pensionistëve dhe të shtresave në nevojë, përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të energjisë elektrike, avancimin e projekteve të fushës së ujësjellës-kanalizimeve dhe arsimit profesional, si dhe rritjen e mbështetjes financiare për personelin e disa institucioneve të rëndësishme buxhetore.

Me aktin normativ nr. 2 të datës 19.12.2018, i cili pa ndryshuar treguesit kryesorë makroekonomikë të parashikuar në fillim të vitit, rriti mbështetjen financiare për buxhetin vendor, financoi disa projekte të rëndësishme në fushën e infrastrukturës rrugore, arsimore, shëndetësisë dhe kulturës. Në mënyrë të posaçme krijoi mundësitë për pagesat e prapambetura nga institucionet shtetërore. Për sa u përket disa karakteristikave kryesore të buxhetit të vitit 2018, përmirësimin apo përsheptimin e rritjes ekonomike të vendit dhe ndikimin e ndërsjellë në treguesit e tjerë ekonomikë, gjatë vitit 2018 ekonomia shqiptare vijoi tendencën pozitive dhe përsheptuese të rritjes, tendencë kjo e arritur që prej vitit 2014, ku rritja reale e PBB-së për vitin 2018 arriti nivelin 4,1% nga 3,8% që ishte një vit më parë.

Ky nivel i rritjes ekonomike është 4 herë më i lartë nëse e krahasojmë me nivelin 1%, i cili ishte arritur në vitin 2013. Rritje ekonomike ndër vite, duke përfshirë dhe parashikimin për periudhën afatmesme e kemi edhe në grafikët që shoqërojnë relacionin e këtij projektligji. Rritja ekonomike në vendin tonë ka një bazë të gjerë në këndvështrimin e komponentëve të kërkesës agregate dhe në shpërndarjen sektoriale. Kërkesa agregate ka vijuar të rritet, duke sjellë rritjen e prodhimit, zgjerimin e punësimit dhe përmirësimin e ekuilibrave kryesorë ekonomike dhe financiare të vendit. Rritja e kësaj kërkesë ka qenë rezultat i rritjes së konsumit privat me 3, e investimeve me 2,7% dhe e eksporteve me 13,7%. Kontribut mjaft

pozitiv dhanë investimet e huaja direkte të cilat u rritën me 13%. Rritja reale e PBB-së ishte diversifikuar edhe në sektorë kryesorë të ekonomisë. Sektori me kontributin më të lartë ishte ai i industrisë i ndjekur nga sektorë të tjerë të shërbimeve, bujqësisë dhe ndërtimit. Rritja ekonomike në Shqipëri, është ndër më të lartat në rajon duke u renditur e dyta në Ballkanin Perëndimor pas Malit të Zi. Rritmi i lartë i rritjes ekonomike është vlerësuar pozitivisht edhe nga institucione ndërkombëtare, që mbikëqyrin ekonominë e vendit tonë, si Komisioni European, FMN-ja dhe BB-ja. Në raportimet e tyre periodike, krahas vlerësimeve pozitive ata kanë rekomanduar që të bëhen përmirësime të mëtejshme në qeverisje, në mjedisin e biznesit, pra në klimën e tij, shfrytëzimin e kapaciteteve prodhuese, reformat strukturore dhe luftën kundër korrupsionit.

Për sa u përket zgjerimit të tregut të punës, zgjerimi i ekonomisë u pasqyrua edhe në tregun e punës, ku norma e papunësisë arriti nivelin më të ulët ndër vite dhe për vitin 2018 kjo normë papunësie ishte 12,8% nga 14,1% që ishte një vit më parë. Norma e papunësisë në Shqipëri është ndër më të ulëtat në vendet e Ballkanit Perëndimor. Punësimi u rrit me 1,4% , ose me 16 mijë të punësuar në krahasim me një vit më parë.

Në lidhje me përmirësimin apo rezultatet e arritura në sektorin e jashtëm pati arritje pozitive ku deficit i bilancit tregtar u përmirësua me 6,3 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Në këtë rezultat ndikoi rritja e eksporteve me 13,7% dhe rritja e importeve me 2,4% krahasuar me vitin 2017.

Gjithashtu bilanci i pagesave u rrit ndjeshëm, ndërsa deficit i llogarisë korrente u ngushtua me 6,7% të PBB-së. Përmirësime të ndjeshme u arritën edhe në llogarinë financiare, ku një ndikim të konsiderueshëm pati rritja e fluksit hyrës të investimeve të huaja direkte me 13%, të cilat, në vlerë absolute, shkuan mbi 1 miliard euro.

Për sa i përket konsolidimit të mëtejshëm fiskal politika fiskale vijoi kursin konsolidues, duke luajtur një lojë të rëndësishme në forcimin e stabilitetit makroekonomik të vendit dhe zhvillimin e ekonomisë. Kjo u shpreh nëpërmjet treguesve si më poshtë:

Deficiti buxhetor, i cili vazhdoi në trajektoren zbritëse me 1,6% të PBB-së në fund të vitit 2018 nga 2 pikë përqind që ishte një vit më parë. Ky nivel i deficitit buxhetor faktik është 0,4% më i ulët se plani. Bilanci primar fiskal u rrit në terma pozitivë, duke arritur 0,6% të PBB-së, nga 0,1% e PBB-së që ishte një vit më parë. Bilanci korrent fiskal arriti 3,2% të PBB-së nga 3% që ishte një vit më parë. Kjo tregon se shpenzimet korrente për vitin 2018, dhe vlen për t'u theksuar këtë rast, janë mbuluar tërësisht nga të ardhurat, duke zbatuar rregullin fiskal të përcaktuar në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor, madje rreth 2% e të ardhurave buxhetore janë përdorur për financimin e investimeve publike. Stoku i borxhit publik bruto u reduktua nga 70,1% e PBB-së në vitin 2017 në 67,2% të PBB-së në vitin 2018.

Ndjekja e një politike stimuluese dhe të kujdesshme monetare. Politika vazhdon të jetë stimuluese, duke dhënë një kontribut pozitiv në ekonomi nëpërmjet gjenerimit të një ambienti financiar me norma të ulëta interesi dhe frenimit të presioneve mbiçmuese për kursin e këmbimit. Norma mesatare e inflacionit pësoi një rritje të lehtë, duke arritur në 2,1% në vitin 2018 nga 2% që ishte një vit më parë. Pritshmëritë për dy vitet e ardhme janë për një trend gradual të rritjes së inflacionit drejt ekuilibrit. Kjo ecuri diktohet nga përmirësimi i mëtejshëm i pozicionit ciklik të vendit i pasqyruar në tendencat rënëse të normës së papunësisë, si dhe në përmirësimin e shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese.

Për sa i përket normave të interesit të depozitave, kredive dhe letrave me vlerë të qeverise ishin në nivelet më të ulëta ndër vite dhe sektori bankar vijoi të karakterizohej nga nivele të mira likuiditeti, kapitali dhe përfitueshmërie.

Raporti i kredisë me probleme zbriti në 11,1% në fund të vitit 2018. Kredia për sektorin privat shfaq shenja rigjallërimi. Stoku i kredisë për sektorin privat paraqitet në rënie, duke u ndikuar nga efekti i pastrimit nga bilanci të kredive me probleme dhe ai i kursit të këmbimit. Duke përjashtuar këto dy efekte kredia për sektorin privat shënoi një rritje vjetore me 5% në fund vitit 2018. Monedha vendase u forcua kundrejt euros, ku ndikimin më të madh e dha përmirësimi i pozicionit të jashtëm të ekonomisë.

Për sa u përket të ardhurave të përgjithshme të buxhetit, duke u bazuar dhe mbështetur në konsolidimin fiskal, për vitin 2018 ishin 449,5 miliardë duke u rritur me 19,1 miliardë apo 4,4 % në krahasim me një vit më parë. Në krahasim me planin këto të ardhura u realizuan në masën 97,3%. Të ardhurat e përgjithshme për vitin 2018 përbëjnë 27,6% të PBB-së, apo 1 pikë përqindje më shumë se mesatarja e 5 viteve të fundit. Kjo rritje të ardhurash erdhi si rezultat i rritjes së punësimit, aktivitetit të biznesit privat, konsumit të brendshëm, si dhe përmirësimit të performancës në mbledhjen dhe administrimin e tyre në kuadër të reformës së konsolidimit të financave publike.

Një rol të rëndësishëm në realizim luajtën politikat fiskale të ndjekura të cilat synuan vendosjen e një taksimi të drejtë të balancuar, që nxit produktivitetin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të ekonomisë. Ndryshimet në paketën fiskale sollën thjeshtimin e procedurave tatimore, si dhe mbështetjen e biznesit dhe të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Mbështetje më të madhe u dha për sektorët e turizmit, të teknologjisë së informacionit për të siguruar rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë dhe zhvillimit në tërësi të saj. Peshën kryesore në rritjen e të ardhurave të përgjithshme të buxhetit e dhanë të ardhurat tatimore, të cilat përbëjnë 93% të totalit. Me gjithë efektin negativ të ndryshimit të kursit të këmbimit të monedhave euro dhe dollar kundrejt monedhës vendase, të cilat sollën ulje të të ardhurave nga importi, të ardhurat tatimore u rritën me 20,7 miliardë lekë apo 5,2% në krahasim me një

vit më parë. Në rritjen e të ardhurave tatimore ndikimin kryesor e dha rritja e të ardhurave nga tatimet dhe doganat, të cilat përbëjnë 68% të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura u rritën si rezultat i përmirësimit të deklarimit të të ardhurave nga biznesi, si dhe thellimit të luftës kundër informalitetit dhe, në mënyrë të posaçme, evazionit fiskal.

Ndikim pozitiv në të ardhurat e përgjithshme sollën edhe të ardhurat nga buxheti i pushtetit vendor, fondet speciale dhe të ardhurat jotatimore. Rritja e të ardhurave nga fondet speciale ishte rezultat i rritjes së numrit të të punësuarve, që solli rritje të numrit të kontribuuesve nga rritja e fondit të pagave.

Në lidhje me shpenzimet të përgjithshme të buxhetit dhe përmirësimit të cilësisë së tyre për vitin 2018, arritën në nivelin 476,1 miliardë lekë në një rritje prej 14,7 miliardë lekësh apo 3,2 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Në krahasim me planin, këto shpenzime u realizuan në masën 96,3%. Këto shpenzime përbëjnë 28,9% të produktit të brendshëm bruto, duke ruajtur një nivel të qëndrueshëm ndër vite.

Tipar kryesor i shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit për vitin 2018 është përmirësimi i cilësisë së tyre. Kjo duket në faktin që ritmi i rritjes së shpenzimeve kapitale në vitin 2018, përkundrejt një viti më parë, është 14,6%, ndërkohë që shpenzimet korrente janë rritur me 3,9%. Pra, ritmi i rritjes së shpenzimeve kapitale është gati katër herë më i lartë se ritmi i rritjes së shpenzimeve korrente, duke i dhënë prioritet rritjes së investimeve në ekonomi.

Rritja me ritme të larta e investimeve publike soli zgjerim të veprimtarisë së biznesit, rritje të punësimit dhe ritëm të lartë të rritjes ekonomike. Investimet publike u rritën me rreth 10 miliardë lekë në krahasim me një vit më parë. Rritja u arrit si në investime me financim të brendshëm, ashtu edhe me financim të jashtëm.

Gjatë vitit 2018 përfunduan së realizuari rreth 111 kontrata investimesh me financim të brendshëm, nëpërmjet të cilave u arrit të kryhen rikonstruksione dhe ndërtime shkollash, përmirësim aksesesh rrugore, përmirësim në sistemin e ujësjellës kanalizimeve, ndërtime të argjinaturave të lumenjve, modernizimi i strukturave të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, mbështetje e Forcave të Armatosura dhe realizim i disa veprave të trashëgimisë kulturore.

Nëpërmjet financimit të huaj për investime u arrit mbështetja e sektorit energjetik, si dhe u realizuan më shumë kontrata në akset rrugore të vendit. Vlen të përmendet që me rëndësi të veçantë kanë qenë disa prej tyre, si përfundimi i punimeve në akset rrugore Plepa - Kavajë – Rrogozhinë, Fushë Krujë – Milot – Morinë, Qafë Thanë - Lin – Pogradec, Elbasan – **Bajzë**, si dhe rrugët lidhëse me bregdetin Jon.

Investime të rëndësishme u kryen edhe për përmirësimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime, veçanërisht në zonat turistike, si një nga sektorët kyç të ekonomisë.

Gjatë vitit 2018 rëndësi e veçantë i është kushtuar thellimit të procesit të decentralizimit dhe përmirësimit dhe menaxhimit të financave publike vendore, sikundër ka ndodhur në vitet e fundit, si dhe zbatimit të reformës administrativo-territoriale. Kjo solli zbatimin më të plotë të funksioneve të pushtetit vendor, zgjerimin e gamës së shërbimeve ndaj qytetarëve dhe përmirësimin e cilësisë së tyre. Shpenzimet për pushtetin vendor arritën në nivelin 49,6 miliardë lekë, duke u rritur me 3,1 miliardë lekë apo 6,7 pikë përqindje në krahasim me vitin e mëparshëm.

Pushteti vendor thelloi më tej tendencën pozitive të mbledhjes së të ardhurave, të cilat për vitin 2018 arritën në nivelin 21,9 miliardë lekë. Këto të ardhura janë 1,3 miliardë lekë apo 6,2 pikë përqindje më të larta se një vit më parë.

Për sa i përket përmirësimit të menaxhimit të borxhit publik, borxhi publik vazhdoi të ketë një tendencë uljeje vitet e fundit, duke qenë se është në përputhje me nivelin e planifikuar dhe me objektivat e strategjisë afatmesme për menaxhimin e tij. Niveli i borxhit publik në raport me produktin e brendshëm bruto, për të tretin vit radhazi, rezultoi në rënie. Stoku i borxhit publik në fund të vitit 2018 ishte 67,2% e produktit të brendshëm bruto, nga 70,1% e produktit të brendshëm bruto që ishte një vit më parë, pra me një rënie me 2,9 pikë përqindje.

Ulja e huamarrjes totale në sektorin publik, si edhe mbështetja në tregun e huaj për financimin e një pjese të madhe të saj rritën hapësirat për kreditimin e sektorit privat. Huamarrja e brendshme dhe ajo e huaj mundësuan rifinancimin e borxhit ekzistues dhe financimin e deficitit buxhetor. Një rol të rëndësishëm në këtë huamarrjeje luajti emetimi i eurobondit në shumën 500 milionë euro, i cili jo vetëm plotësoi nevojat për likuiditet për vitet 2018 dhe 2019, por ndikoi edhe në mbajtjen nën kontroll të riskut të rifinancimit dhe riskut të normave të interesit në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme.

Për sa i përket mbështetjes së reformave strukturore, edhe gjatë vitit 2018 buxheti vijoi mbështetjen e reformave në sektorët kyç të ekonomisë, si në drejtësi, administratën publike dhe në menaxhimin e financave publike. Gjatë këtij viti u arritën rezultate pozitive në të gjithë sektorët e ekonomisë, veçanërisht në sektorët e shëndetësisë, arsimit, bujqësisë, infrastrukturës, energjisë dhe furnizimit me ujë, si dhe turizmit.

Këto reforma ndikuan në nxitjen e zhvillimit të ekonomisë, në zgjerimin e veprimtarisë së biznesit, si edhe në përmirësimin e shërbimit ndaj qytetarëve.

Për sa i përket raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Kontrolli i Lartë i Shtetit, si institucioni që kryen auditimin e jashtëm publik, ka ushtruar veprimtarinë audituese mbi

zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2018, gjatë së cilës është fokusuar në identifikimin e risqeve kryesore për financat publike në kontekstin afatmesëm dhe afatgjatë. Gjatë kësaj veprimtarie KLSH ka konstatuar disa problematika, të cilat janë pasqyruar në raportin e këtij institucioni mbi zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2018.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe të gjitha strukturat buxhetore duhet të shqyrtojnë dhe analizojnë të gjitha problematikat e konstatuara nga KLSH dhe të marrin masa për përmirësimin e gjendjes, me qëllim që ligjet të respektohen me korrektësi dhe të ndërmerren në kohën e duhur masat parandaluese ndaj risqeve që mund të dëmtojnë procesin e hartimit dhe zbatimit të buxhetit të shtetit.

Këto problematika duhet të mbahen në konsideratë gjatë hartimit të projektbuxhetit për vitin 2020, i cili do të shqyrtohet së shpejti në Kuvend.

Gjithashtu, në përfundim, i sugjeroj ministrisë të rishikojë edhe një herë disa shifra, për sa kohë në përsëritjen e tyre në faqe të ndryshme ka disa pasaktësi.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Unë mendoj që fillimisht të procedojmë me Kontrollin e Lartë të Shtetit. Ministria, si mendoni?

Po, zonja Lindita, ju lutem tregohuni koncize!

Lindita Milo – Faleminderit!

I nderuar zoti Ahmetaj, kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave!

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë!

Më lejoni që, në emër të kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, zotit Leskaj, të paraqes përpara këtij komisioni të nderuar gjetjet kryesore të raportit për zbatimin e buxhetit të shtetit, i cili është produkt i punës në grup të të gjithë punonjësve dhe kryesisht të departamentit të auditimit të buxhetit të shtetit, sikurse edhe të gjithë audituesve të tjerë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përmbushje të misionit kushtetues, si dhe në zbatim të ligjit nr. 154 “Për organizmin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka realizuar aktivitetin auditues “Mbi zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2018” në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditivit, të aplikuara nga institucionet supreme të auditimit dhe praktikat më të mira të Komitetit të INTOSAI dhe EUROSAT.

Kontrolli i Lartë i Shtetit vlerëson punën dhe përpjekjet pozitive të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e strategjisë së menaxhimit të financave publike 2014-2020. Theksojmë se për mirëmenaxhimin e financave publike dhe zbatimin e strategjisë përgjegjësia nuk është vetëm e këtij institucioni, por e të gjithë aktorëve dhe faktorëve, duke

përfshirë Kuvendin e Shqipërisë, qeverinë dhe institucionet kryesore, përfshirë edhe Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në zbatim të kërkesave të ISSAI dhe konkretisht të standardit ndërkombëtar 1700, ka formuluar opinionin dhe raportin e zbatimit të buxhetit të shtetit për vitin 2018, i cili është bazuar në gjetjet dhe rekomandimet e auditimeve të përputhshmërisë në lidhje me hartimin, zbatimin, monitorimin, si dhe saktësimin e raportimit të buxhetit të shtetit për këtë vit, duke u bazuar në: raportin e zbatimit të buxhetit vjetor 2018; raportin e borxhit publik; raportin e përdorimit të fondeve rezervë dhe të kontingjencës; raportin mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme për vitin 2018, si dhe pasqyrat e konsoliduara vjetore të transaksioneve financiare të shtetit.

Bazuar në evidencat e auditimit, mbi të cilat janë formuluar gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, Kontrolli i Lartë i Shtetit konkludon se, pavarësisht përpjekjeve dhe punës së bërë për ndërtimin e sistemeve të kontrollit për menaxhimin e financave të fondeve publike, nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për disa zëra buxhetorë, përfshirë nivelin e deficitit dhe të borxhit publik ka devijime materiale të përhapura në drejtim të hartimit, ekzekutimit, monitorimit dhe raportimit jo në përputhje me ligjin për buxhetin e vitit 2018, i ndryshuar, në përputhje me ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, kundrejt ligjit “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, sikurse edhe ligjit “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe një sërë ligjesh, të cilat ne kemi marrë në konsideratë gjatë analizës për të parë nivelin e përputhshmërisë së këtij aktivitetin kundrejt kësaj baze ligjore.

Në lidhje me treguesit e konsoliduar fiskalë të buxhetit të vitit 2018, bazuar në të dhënat e raportuara nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, të ardhurat e përgjithshme të buxhetit të shtetit për vitin 2018 janë realizuar rreth 4,5% më shumë krahasuar me vitin e kaluar, por të pa realizuara 2,6% kundrejt planit të rishikuar vjetor.

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit për vitin e kaluar janë realizuar 3,16% më shumë krahasuar me vitin 2017, por të pa realizuara 1,3% kundrejt ligjit të buxhetit.

Ky nivel shpenzimesh ka mundësuar që deficitin të jetë nën 2% e produktit të përgjithshëm bruto. Deficiti buxhetor i raportuar për vitin 2018 është realizuar në masën 81,1% dhe rezulton të jetë sa 1,6% e prodhimit të përgjithshëm bruto, çka në aspektin formal rezulton brenda limitit ligjor prej 2% të produktit të përgjithshëm bruto.

Nga auditimet kemi konstatuar që niveli faktik i deficitit është i nënvlerësuar. Në vlerësimin e KLSH-së detyrimet e prapambetura janë rritur me rreth 12 miliardë në krahasim me një vit më parë, duke kapur shifrën 42 miliardë në fund të vitit 2018.

Nëse do të përfshihej rritja e detyrimeve të prapambetura gjatë vitit 2018 duke raportuar shpenzimet kur ato ndodhin, deficitin do të ishte rreth 2,2% e produktit të përgjithshëm bruto. Procesi i buxhetimit fillestar dhe ndryshimet në të, bazuar në problematikat e evidentuara për disa zëra të treguesve fiskalë, nuk i përgjigjet kërkesave ligjore për alokimet e fondeve, nuk reflekton prioritetet në buxhetim për sa u përket kontratave në vazhdim dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, duke mundësuar alokimin e burimeve drejt projekteve të reja. Buxheti optimist dhe jo në përputhje me kërkesat ligjore rrit presionin ndaj treguesve kryesorë fiskalë dhe krijon premisa për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Si rezultat i problematikave të përhapura dhe materiale, duke vlerësuar punën e stafeve teknike për të mbajtur nën kontroll situatën, KLSH-ja ka kërkuar që të kushtohet vëmendje maksimale në menaxhimin e financave publike.

Për sa i përket procesit të programimit buxhetor, për shumë institucione buxhetore vazhdon problematika në drejtim të hartimit të dokumentit në përputhje me programin buxhetor afatmesëm. Kjo lidhet kryesisht me problematikën që ka derivuar nga procesi i riorganizimit të ministrive.

Gjatë procesit të hartimit të buxhetit për vitet 2018-2020 tavanet indikative përfaqësojnë një bashkim mekanik të programeve ekzistuese në përputhje me riorganizimin rristrukturor. Gjithashtu, ata janë paraqitur vetëm për shpenzimet korrente dhe kapitale, pa përfshirë shpenzimet e personelit.

Një element tjetër që ne kemi evidentuar dhe që duam ta prezantojmë në këtë komision të nderuar lidhet me regjistrimin e planit të buxhetit të shtetit në sistemin informatik financiar të qeverisë. Nga auditimet është konstatuar se ky plan paraqitet me diferenca në nivel zërash buxhetor. Kështu, shpenzimet e përgjithshme dhe financimi i deficitit për vitin 2018 rezulton të jetë regjistruar me vlerën 14, 09 milionë më pak se akti normativ nr.2, datë 19. 12. 2018.

Këto evidenca tregojnë se çeljet e fondeve, monitorimi dhe ekzekutimi i buxhetit nëpërmjet sistemit të thesarit nuk janë në përputhje me tavanet buxhetore të miratuara, veprim i cili bart riskun e mosrespektimit të ligjit vjetor të buxhetit.

Një element tjetër që do të donim të vendosnim në dukje është se nga auditimi për planifikimin, detajimin dhe rishpërndarjen e fondeve buxhetore për projektet e investimeve, *Hardware*, *Software*, në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, u

konstatuan parregullsi në procedura dhe në vendimmarrje. Për shembull, ky projekt ka filluar kur nuk ishin realizuar procedurat e miratimit si një investim publik, sikurse edhe nuk është pjesë e listës së investimeve publike për periudhën 2018-2020.

Gjithashtu, kemi vënë re se për këtë projekt nuk ka një vlerësim të detajuar për analizën ekonomike-financiare, studim të plotë apo të pjesshëm të fizibilitetit, skenarë të fluksit të parasë, alternativa të dizenjimit të projektit, planin e prokurimit e të tjera. Sipas rastit, vlera e tij kalon shifrën 150 milionë lekë.

E sollëm këtë shembull thjesht për të treguar se ka fenomene të tilla dhe ne jemi këtu për të evidentuar se si duhet të përmirësohet mirëqeverisja dhe mirëfunksionimi i kontrollit dhe menaxhimit të financave publike.

Nga auditimi mbi planifikimin, detajimin dhe rishpërndarjen e fondeve publike për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm u konstatuan parregullsi dhe vendimmarrje jo në përputhje me rregullat dhe kriteret ligjore në drejtim të identifikimit, vlerësimit dhe miratimit të projekteve të investimeve publike të paraqitura nga institucionet buxhetore; të sigurimit të procesit të përfshirjes së projekteve të investimeve të përzgjedhura në programin buxhetor afatshkurtër dhe në buxhetin vjetor; çeljes së projekteve të investimeve në proces me akte normative; çelja e investimeve publike pa kaluar proceset e menaxhimit të investimeve publike e të tjera, si dhe të monitorimit si një proces në tërësi, konstatohet se 32% e realizimit të detyrimeve me kapital të brendshëm realizohet në muajin dhjetor. Pra, sjell një mbingarkesë në shpërndarjen e fondeve. Ky fenomen, që ekziston prej vitesh dhe i trajtuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, shton riskun e uljes së eficiencës së projekteve të investimeve publike. Veprime të tilla në kundërshtim me parimet dhe rregullat e funksionimit të sistemit buxhetor tregojnë për një planifikim të dobët të investimeve publike nga institucionet buxhetore, si dhe mungon një monitorim i mjaftueshëm nga ana e ministrisë për të garantuar menaxhimin eficient dhe transparent të fondeve publike.

Nga auditimi me zgjedhje u konstatua se janë çelur me përshkrimin “fond i ngrirë” investime me vlerën 2,495 milionë lekë, që përfaqësojnë projekte investimi në sisteme informatike, rrugë ndërtimi, projekte pa përshkrim, në kundërshtim me ligjin e buxhetit, si dhe një mekanizëm ekstrarregullator, që mundëson akomodimin e projekteve në buxhet pa plotësuar të gjitha kërkesat ligjore në kohë.

Nga auditimi i sistemit të thesarit, ashtu si një vit më parë, janë konstatuar thyerje të sistemeve të kontrollit gjatë të gjitha hallkave, të vendosura për mirëmenaxhimin e financave publike.

K Kontrolli i Lartë i Shtetit ka konstatuar problematika në lidhje me çeljet buxhetore dhe rishikimin e planit buxhetor në këtë sistem për vitin buxhetor 2018.

Një tjetër fenomen i konstatuar është numri i lartë i rishikimeve buxhetore gjatë vitit 2018, për shembull, 2065 regjistrime fletë-kontabël nga 1600 njësi ekonomike për 1179 projekte, për investime kryesisht nga njësitë e qeverisjes vendore, por dhe nga ministrinë e tjerat të linjës.

Kontrolli i Lartë i Shtetit konstaton se janë marrë angazhime pa fonde buxhetore disponibël ose/dhe për projekte pa kaluar në procesin ligjor të miratimit në planin buxhetor afatmesëm, të konstatuara në 11 projekte me një vlerë totale fondi buxhetor prej 14,6 miliardë lekësh, në kundërshtim me ligjin “Për menaxhimin buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Janë evidentuar edhe një sërë elementesh të tjera që lidhen me urdhërprokurimet apo me pagesa. Nga krahasimi i tyre me të dhënat e dërguara nga APP-ja konstatohet raste të kontratave të lidhura me shuma më të larta se fondet e miratuar, pra fondi limit pa TVSH-në sipas rregullave është më i lartë se fondi disponibël i regjistruar në sistemin financiar të qeverisë.

Fenomeni i regjistrimit me vonesë të kontratave të lidhura nga institucionet qendrore dhe vendore vazhdon të jetë i përhapur edhe gjatë vitit 2018. 64% e të gjitha kontratave të regjistruara, me një vlerë prej 64 miliardë lekësh rezultojnë me thyerje të afatit ligjor 5-ditor, në kundërshtim me pikën 144 të udhëzimit nr. 2 të 12-s për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit të shtetit.

Gjatë vitit 2018 nga auditimi konstatuam përsëri fenomenin e regjistrimit të kontratës dhe faturës në të njëjtën ditë, ku si rrjedhojë në rreth 150 raste, me një vlerë prej 7 miliardë lekësh, regjistrimi i kontratës është formal dhe vetëm si pjesë e rutinës së regjistrimit të faturës.

Gjatë vitit 2018 konstatohet regjistrime të pjesshme të kontratave, në total 15 kontrata me një vlerë 2 miliardë lekë.

Nga auditimi konstatuam mbi 33 mijë raste, me një total vlerë monetare 44,3 miliardë lekë të faturave të dorëzuara në thesar jashtë afatit 30-ditor, në kundërshtim me ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor.

Pavarësisht shkeljeve të përhapura, kërkesave ligjore dhe rekomandimeve të KLSH-së, me qëllim disiplinimin e menaxhimit të financave publike, nga nëpunësi i parë i autorizuar nuk është marrë asnjë masë administrative, si dhe nuk është iniciuar asnjë inspektim financiar në zbatim të nenit 69 të inspektimit financiar, megjithëse ka një rritje të numrit të rasteve të raportuara nga degët e thesarit në krahasim me një vit më parë. Nëse marrim në konsideratë numrin e lartë të shkeljeve të afateve ligjore ato mbeten ende minimale dhe pa impakt në përmirësimin dhe parandalimin e detyrimeve të prapambetura.

Mbi implementimin e buxhetit të shtetit

Referuar realizmit faktik të të ardhurave buxhetore për vitin e kaluar, konstatohet se planifikimi fillestar ka parashikuar një rritje të të ardhurave në masën 7,9% krahasuar me 2017-n. Faktikisht, është realizuar në masën 4,5%.

Edhe për këtë vit u konstatua planifikimi optimist i të ardhurave. Megjithatë, duhet theksuar se mosrealizimi i të ardhurave tatimore, veçanërisht i atyre nga tatimet dhe doganat, përkatësisht në masën 0,5% dhe 3,8% kundrejt planifikimit fillestar, ka ndikuar në rritjen e stokut të TVSH-së së rimbursueshme, 81,5% më i lartë se viti 2017, dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura, të cilat nuk janë të deklaruara në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar.

Nga auditimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve janë konstatuar problematika në lidhje me skemën e rimbursimit të TVSH-së dhe probleme me mbledhjen e borxhit tatimor.

Sjellim në vëmendje se ndryshimet e vazhdueshme në kuadrin fiskal sjellin një klimë të paqëndrueshme për biznesin dhe krijojnë problematika në administrimin e të ardhurave tatimore. Kemi gjykuar se me ndryshimin e normës së tatimit mbi dividendin në 8%, me efekt prapaveprues, bëhet fjalë për një amnisti fiskale, që krijon një pabarazi fiskale në raport me individët apo aksionerët, që gjatë këtyre viteve kanë shpërndarë dividendin e tyre deri në vitin 2017.

Të ardhurat fiskale doganore kanë një rritje më të vogël në krahasim me 2017-n, kur rritja ishte 6,9% krahasuar me një vit më parë.

Nga auditimet në administratën doganore në qendër dhe në degë kanë rezultuar veprime dhe mosveprime në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit doganor, si dhe të dispozitave të tjera ligjore e nënligjore mbi bazën e të cilave ushtron veprimtarinë administrata doganore, që në total kanë sjellë 989 milionë lekë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

Të ardhurat nga buxheti vendor sipas planit fillestar janë realizuar në masën 116% apo 106% kundrejt planit të rishikuar. Të ardhurat jotatimore janë realizuar në masën 87% të planit vjetor fillestar.

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit të shtetit për vitin 2018 janë realizuar në masën 95,8% ndaj planit vjetor fillestar ose 96,3% ndaj atij të rishikuar.

Shpenzimet korrente janë raportuar të realizuara në masën 2,6% më pak se plani i rishikuar.

Shpenzimet kapitale janë realizuar 93,2% ndaj planit të rishikuar.

Disa nga problematikat në lidhje me menaxhimin e shpenzimeve buxhetore paraqiten si më poshtë, ku KLSH-ja është përqendruar në çështje me ndikime në treguesit fiskalë, ku ka

hapësira edhe për rritjen e eficiencës në përdorimin e fondeve publike. Në radhë të parë, janë shpenzimet për vendimet gjyqësore.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka konstatuar se vendimet gjyqësore të formës së prerë nuk raportohen dhe nuk deklarohen si shpenzime, në kundërshtim me nenin 61 të ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”. Kjo krijon kushte për akumulimin e kamatëvonesave si pasojë e vonesës në shlyerjen e tyre, nënvlerësimin e shpenzimeve të vitit dhe të deficitit të vitit buxhetor, pagesën e tarifave përmbartimore, si pasojë e mosekzekutimit vullnetar të vendimeve dhe thyerje të radhës së shlyerjes së vendimeve dhe selektivitetit në përzgjedhjen e tyre.

Efekti i pagesave të kryera nga buxheti i shtetit për 2018-n për largimin e padrejtë të punonjësve nga puna nëpërmjet llogarive të shpenzimeve operative, pra të pasqyruara në llogaritë e shpenzimeve operative, vlerësohet në rreth 1,6 miliardë dhe për vendimet e tjera gjyqësore është vlerësuar rreth 0,8 miliardë lekë.

Sipas raportimit nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në fund të datës 31.12.2018, teprica e llogarisë në lidhje me vendimet gjyqësore është evidentuar në rreth 3 miliardë lekë. Vetëm 10 institucione buxhetore mbajnë rreth 50% të pagesave për punonjësit e larguar padrejtësisht nga puna, të konstatuara me vendim gjykate.

Nga ana tjetër, në shumë institucione nuk ekziston baza e të dhënave mbi vendime gjyqësore, për rrjedhojë KLSH-ja nuk mund të raportojë për efektin e detyrimeve nga vendimet gjyqësore që kanë marrë formë të prerë.

Mbi administrimin e burimeve njerëzore (një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm, ku ne jemi fokusuar për të evidentuar problematikat).

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve mbi administrimin e burimeve njerëzore dhe kostot e keqadministrimit të tyre ndër vite, KLSH-ja ka evidentuar dhe konstatuar problematika të shumta. Faktikisht, sikurse është paraqitur gjerësisht në raport, janë kontrolluar disa institucione kryesore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ku janë evidentuar rreth 12 punonjës, të cilët marrin 2 pagesa nga buxheti i shtetit. Është marrë në trajtesë FSDKSH-ja dhe njëkohësisht është parë edhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duke evidentuar përkatësisht edhe dëmet respektive që lidhen me këtë aspekt.

Fondi rezervë i buxhetit të shtetit dhe fondi i kontigjencës janë pjesë përbërëse e buxhetit të shtetit.

Për vitin 2018 është përdorur vetëm 98% e fondit të planifikuar në lidhje me fondin rezervë, por 35% më pak se viti i mëparshëm.

Nga auditimi i përdorimit të fondit rezervë të buxhetit të shtetit janë vënë re mangësi në dokumentacion apo shkelje në përdorimin e tij, që zënë 63% të vlerës totale të përdorimit.

Disa nga aspektet kryesore janë: në 7 vendime të qeverisë, që përbëjnë 23,6% të vlerës së përdorur nga ky fond, nuk ka relacione shpjeguese për shpenzime që kërkohen nga institucionet përfituese në përdorimin e tij; në 8 vendime të qeverisë, që përbëjnë 30% të vlerës së këtij fondi, nuk ka preventiv shpenzimesh nga institucionet përfituese; në 5 VKM, që përbëjnë 35,7% të fondit vihet re se këto fonde janë përdorur si shtesë buxheti.

Nga auditimi i vendimeve të Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut rezultoi se këtë vit është likuiduar vlera më e vogël e 10 vjetëve të fundit dhe kjo është realizuar nëpërmjet ekzekutimit të tri vendimeve të qeverisë, por janë paguar përsëri kamatëvonesa me një vlerë 22,8 mijë lekë, të llogaritura nga momenti i daljes së vendimit nga Gjykata Europiane.

Fondi i ish-të përndjekurve politikë në vitin 2018, referuar tabelës së treguesve fiskalë është realizuar në masën 48% në raport me planin vjetor fillestar dhe 97% në raport me planin përfundimtar, pra me planin e rishikuar.

Konstatohet se vlera e detyrimit të njohur nga shtetit shqiptar dhe i papaguar për ish-të përndjekurit politikë deri në fund të vitit 2018 është 33,381 milionë lekë. Ndërsa buxhetimi i këtij fondi do të vazhdojë me këtë ritëm, ky detyrim do të mund të shlyhet vetëm mbas 33 vjetësh, kundrejt 16 vjetësh që ishte buxhetimi fillestar. Për të ruajtur vlerën reale të kompensimit, duke pasur në konsideratë kohën e gjatë, do të duhej që detyrimet e njohura pas kësaj shtese të indeksohen edhe me inflacionin, një aspekt tjetër që duhet marrë në konsideratë.

Në lidhje me administrimin e skemës së sigurimeve deficiti i degës së pensioneve për vitin 2018 rezultoi në shumën 26, 965 milionë lekë kundrejt planit fillestar. Ky tregues u pakësua me 493 milionë lekë apo rreth 1,8% më pak në krahasim me 2017-n, kur deficiti ishte 27, 458 milionë lekë.

Në raport me PPB-në ky tregues është përmirësuar me 1,77 pikë në vitin 2017 dhe 1,63 pikë në vitin 2018.

Dua të theksoj se problematikat që ekzistojnë për sa i përket degës së pensioneve të fshatit dhe qytetit janë qartësisht të paraqitura.

Një rezultat pozitiv është vënë re për sa i përket skemës së pensioneve të qytetit, ku skema e sigurimeve shoqërore në qytet arrin të financojë rreth 82,3% të shpenzimeve, ndërsa 17,3% e tyre financohet nga buxheti i shtetit.

Një çështje problematike me ndikime sociale vijon të mbetet borxhi i subjekteve në lidhje me sigurinë shoqërore. Nga të dhënat e ISSH-së është konstatuar se gjatë 2018-s edhe entet publike kanë vijuar të krijojnë detyrime për sigurimet shoqërore. Megjithatë, në këtë sektor, pra për sa i përket efekteve të reformës së sigurimeve shoqërore, është realizuar edhe

auditimi i performancës në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, i cili konkludoi se pavarësisht qëllimeve të mira nuk ka rezultuar efektiv. ISSH-ja nuk ka një strategji institucionale dhe plane veprimi, si pasojë e moskryerjes së analizave kosto-përfitim. Në lidhje me alternativat e mundshme të investimit të fondeve rezervë nga këshilli i administrimit ISSH-ja ka të ardhura të munguara 710 milionë lekë, në qoftë se do të përdorte skema financimi.

Për sa i përket fondit të sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në drejtim të programimit dhe realizimit të sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe pagesave.

Nuk do të doja ta zgjasja, sepse është një aspekt që e trajtuam, por dua të theksoj në mënyrë specifike koncesionet që mbulohen nga ky institucion. Në bazë të të dhënave, dihet që deri në vitin 2018 këto kontrata koncesionare kanë arritur vlerën 3,578 milionë lekë. Ka një sërë problematikash që duhen konsideruar edhe nga Ministria e Financave, sepse brenda të njëjtit sektor, sektorit të shëndetësisë, kemi kontrata koncesionare, ku një pjesë e tyre paguajnë TVSH-në, pra përfshihen në skemën e TVSH-së dhe një pjesë nuk përfshihet. Pra, ky është një element që duhet të shikohet dhe të trajtohet me kujdes.

Është evidentuar fondi i detyrueshëm i kujdesit shëndetësor kundrejt kujdesit të barnave, aspektet e problematikat e tyre dhe një sërë elementesh të tjera që lidhen me marrjen e masave për të rritur eficiencën e monitorimit të këtij institucioni, jo vetëm kundrejt kontratave koncesionare, por edhe efektet që ka te mirëqenia e përgjithshme e njerëzve cilësia e barnave. Materiali shumë i detajuar gjendet në raport.

Mbi administrimin e buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Krahas të dhënave mbi nivelin plotësimit të të ardhurave duam të theksojmë se ka një mosrakordim midis ligjit të buxhetit dhe ligjit specifik të këtyre njësive, të cilat heqin të drejtën e përdorimit të fondeve buxhetore, që barten nga viti i kaluar, gjë që krijon edhe problematika në zbatimin e planeve të tyre buxhetore.

Në lidhje me borxhin tatimor të krijuar nga bashkitë, nga 21 bashki të audituara u vu re se borxhi tatimor paraqitet në vlerë shumë të konsiderueshme, mbi 11 miliardë lekë, dhe vjen gjithmonë në rritje nga njëra periudhë në tjetrën. 90% e këtij borxhi tatimor është krijuar nga 4 bashki: Bashkia e Tiranës, Bashkia e Shkodrës, Bashkia e Sarandës dhe Bashkia e Pogradecit. Kontrolli i Lartë i shtetit, në mënyrë konsistente, nga të gjitha auditimet e kryera ka rekomanduar masa për vjeljen e detyrimeve fiskale në zbatim të dispozitave ligjore.

Për sa u përket prokurimeve publike, do të donim të theksonim se Kontrolli i Lartë i Shtetit ka realizuar një auditim të teknologjisë së informacionit, për qëndrueshmërinë dhe sigurinë e sistemeve të informacionit, si një instrument shumë i rëndësishëm për buxhetimin, dhe njëkohësisht për ushtrimin e kontrollit dhe monitorimit në përdorimin e fondeve publike.

Nga ky auditim u vunë re parregullsi, të cilat evidentuan mungesën e kontrolleve të imputit të të dhënave. Njëkohësisht, u konstatua se sistemi nuk ka filtra të nevojshme për moslejimin e hedhjes gabim së të dhënave në sistem apo duke lejuar lidhjen e kontratave pa pasur fondin limit të nevojshëm. Ky element është konstatuar në fund të vitit 2018 dhe aktualisht, në fund të vitit 2019, APP-ja ka informuar Kontrollin e Lartë të Shtetit për masat e marra për të vendosur filtrat e nevojshëm.

Gjithashtu, nga ky auditim u vu re që vlera e prokuruar për vitin 2018 ka qenë në 14 raste më e madhe se fondi limit, duke krijuar një efekt negativ.

Raportimi i borxhit publik:

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka konstatuar se në programimin e ligjit për buxhetin e vitit 2018 nuk janë vendosur përcaktime sasiore për kufizimin e marrjes së borxhit të ri, duke lejuar mundësinë e rritjes së tij, sipas emetimit të Eurobond-it, duke mos qenë në përputhje me kërkesat e nenit 9 të ligjit për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancinë shtetërore të Republikës së Shqipërisë.

KLSH-ja ka konstatuar krijimin e detyrimeve të reja për shumën 5, 465 milionë lekë të subjekteve nënhuamarrëse në kuadër të marrëveshjes së nënhuas përgjatë vitit 2018, si pasojë e moskryerjes së detyrimeve përkatëse. Sektorët me përqendrim të situatës financiare janë: sektori i energjetikës, kryesisht nënhat e KESH-it, të OSHEE-së, të OSHT-së, me rreth 4,4 miliardë të rritjes totale të detyrimeve nga 5,5 miliardë në total. Pushteti vendor i ka rritur këto detyrime me 0,7 miliardë lekë dhe sektori i ujësjellësve me 0,3 miliardë lekë.

Për vitin 2018 gjendja e detyrimeve për garancinë shtetërore, që subjektet përfituese ...

Arben Ahmetaj – Zonja Lati, do t’ju lutesha ta përmbledhni me pak fjalë, sepse materiali juaj është shumë i detajuar dhe korrekt.

Lindita Milo (Lati) – Elementi që duam të theksojmë, dhe kërkojmë të shikohet me kujdes nga të gjithë, është mënyra e llogaritjes dhe e marrjes në konsideratë e elementeve që lidhen me borxhin publik dhe me detyrimet e prapambetura.

Unë nuk po vijoj të jap elemente, të cilat janë transparente në të gjitha raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, sikurse edhe në raportin e sjellë pranë këtij komisioni të nderuar.

Dua të theksoj në mënyrë specifike një auditim që ne kemi bërë për koncesionet e partneritetit publik privat për të parë nëse respektohet 5%-shi. Në bazë të ligjit të kontratave koncesionare, pagesa që i bëhet koncesionarit nuk duhet të tejkalojë 5% të buxhetit. Nga auditimi që ne kemi bërë u vërtetua se ky 5%, nuk ka kaluar por gjithsesi, ne mendojmë që ju, në vëmendjen tuaj, si ligjvënës, edhe ekzekutivi, duhet të keni në konsideratë ritmin e rritjes ekonomike dhe risqet e rritjes, për të ruajtur pikërisht këtë performancë të mirë të realizuar.

Për menaxhimin financiar dhe kontrollin e sektorit publik, për fat të mirë, pranë Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë është ndërtuar Drejtoria e Harmonizimit, e cila duhet të luajë një rol kyç. Ka një informacion shumë të detajuar jo vetëm për gjetjet e auditimit, por edhe për mënyrën se si duhet konceptuar funksionimi i kësaj drejtorie, sepse duhet të luajë rolin e udhëheqësit metodologjik. Kjo është një nga pistat kryesore, një nga instrumentet kryesore për auditimin e brendshëm të qeverisë. Ka një sërë evidencash që tregojnë se auditimi i brendshëm, i cili auditon ministritë e linjës, nuk është në nivelin që duhet dhe për rrjedhojë, ne, si auditim i jashtëm dhe i brendshëm, jemi pjesë e dhënies së opinionit për mënyrën se si duhet të përmirësohet mirëqeverisja.

Dua të theksoj se vizioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, në përputhje me të gjitha zhvillimet e fundit, ka dhënë një peshë specifike në rritjen e auditivëve të performancës. Gjatë vitit 2018 janë realizuar 16 auditime në sektorët kryesorë, të cilët dua t'i përmend, sepse përbëjnë gjetje, që nuk lidhen thjesht me shifra, por me mënyrën se si funksionojnë sistemet.

Më konkretisht, është bërë auditim për përmbytjet, parandalimin, mbrojtjen, gatishmërinë; për efektivitetin e politikave për nxitjen e barazisë gjinore të grave; për cilësinë dhe tarifimin e shërbimeve studentore pranë IAL-ve publike; për cilësinë dhe sigurinë e barnave në rrjetet farmaceutike; për performancën e Institutit të Sigurimeve Shoqërore; për ndotjen akustike; për rritjen e kapaciteteve në administratën publike; për financimin e klubeve shumësportësh; për efektivitetin e menaxhimit të fondit pyjor dhe kullotësor; për performancën e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara; për performancën e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare; për performancën e parqeve kreative në Tiranë, këndeve të lojërave; për cilësinë e ujit të pijshëm për konsumatorët; për sigurinë rrugore në Shqipëri; për menaxhimin e plazheve publike; efektivitetin e programeve sociale të strehimit.

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Kontrolli i Lartë i Shtetit nëpërmjet aplikimit të qasjeve dhe zhvillimeve të fundit të doktrinės së auditimit të jashtëm publik, të cilat janë konsoliduar në kongresin e 23-të të Intoside, sipas së cilit qeverisja duhet parë si një e tërë, ka adresuar dhe evidentuar statusin e treguesve kryesorë të objektivave strategjike të qeverisë, bazuar në strategjinë e menaxhimit të financave publike 2014-2020. Në këtë mënyrë, institucioni suprem i auditimit shqiptar kontribuon në realizmin e përparësive dhe të objektivave kombëtare, duke ofruar vlera dhe përfitime më të mëdha për palët e interesuara dhe për qytetarin në veçanti.

Faleminderit për vëmendjen!

Arben Ahmetaj – Zonja Lati, ju falënderoj për prezantimin!

Gjithashtu, ju përgëzoj juve dhe stafin tuaj për punën e vazhdueshme nën drejtimin e kryetarit, zotit Leskaj!

Ju falënderoj edhe për sqarimin e tymnajave me PPP-të!

Besoj se ju keni bërë debat edhe brenda KLSH-së dhe më vjen mirë që konkluzionet janë në bazë të ligjit, pra, që Ministria e Financave nuk është autoritet kontraktor me PPP-të, por janë ministritë e linjës.

Ju falënderoj për përpjekjen tuaj për të mos e shtrembëruar ligjin me qëllim!

Tjetra, ju falënderoj për korrektesën në kontabilizimin, në këndvështrimin tuaj, e asaj përqindjeje ligjore, në bazë të ligjit organik të buxhetit, të financimit të partneritetit publik privat, të cilat janë investime publike. Pra, janë praktikisht projekte investimesh publike, shumë më poshtë se 5%-shi e të ardhurave tatimore totale të vitit të kaluar.

Unë kam qenë ministër Financash kur e kam vendosur këtë ligj dhe e kam falënderuar këtë komision dhe parlamentin që më kanë mbështetur. Ajo që thatë ju është e saktë: autoritetet duhet të kenë parasysh ritmet e rritjes në vazhdimësi, në mënyrë që ajo të ngelet gjithmonë nën 5%.

Kam një kërkesë personale si kryetar, por edhe në emër të komisionit, si pjesë e pozitës, por besoj se edhe opozita do të bjerë dakord me mua: Kontrolli i Lartë i Shtetit, mbi të gjitha, ka detyrë të korrektojë fenomene. Ju keni bërë një punë shumë të mirë me rekomandimet ndër vite. Ju lutem, transmetojani kryetarit, në emrin tim, që të mundoheni të prodhoni një manual me rekomandime për t'i kthyer me dy kolona.

Në kolonën e parë të jenë rekomandimet në total dhe mënyra si janë reflektuar. Kur them “rekomandime në total” e kam fjalën për specifika.

Në kolonën e dytë, janë rekomandimet fenomen në funksion të përmirësimit të financave publike.

Gjithashtu, të ketë edhe një inventar të realizimit ose jo të tyre, sepse shumë elemente që përmendni ju janë të vlefshme dhe duhet të merren në konsideratë nga autoritetet. Kjo do të na ndihmojë me një hap shumë të rëndësishëm, që së shpejti të krijojmë nëngrupin, brenda këtij komisioni, që do të monitorojë KLSH-në në bazë të ligjit, por edhe nëngrupin e dedikuar për buxhetin. Ne duam të bashkëpunojmë me ju pasi të analizojmë rekomandimet, (falënderojeni kryetarin nga ana ime për të gjitha rekomandimet ndër vite) t'i kthejmë në një manual rekomandimesh fenomenesh për të plotësuar së bashku rolin tonë, por edhe rolin tuaj si korrektues dhe promovues të përmirësimit të financave publike.

Në eksperiencën time modeste me financat publike, duke krahasuar vitin 2018 me vitet 2005-2010, financat publike në transparencë të tyre, kanë bërë hapa shumë të mëdhenj. Ajo që ju theksuat me të drejtë, është parashikimi dhe mitigimi i risqeve. Vërtet diskutojmë

se ka kaq të ardhura tatimore, kaq të ardhura doganore, kaq u plotësuan e kaq u bënë, por, në fund, produktiviteti, efektshmëria e administratës, në mbledhjen e të ardhurave, në të ardhmen, në institucionin tuaj, duhet të futet si pjesë e rëndësishme, me një metodologji të rëndësishme. Vërtet mund ta bëjmë llogarinë thjesht, që u mbiplanifikuan të ardhurat, të ardhurat mund të mbiplanifikohen, siç është bërë në shumë vite, për shkak të reflektimit të disa elementeve makro, të cilat fluktojnë gjatë periudhës, por kjo është e matshme, sepse ekonomia rritet-bie, konsumi rritet-bie, eksporti rritet-bie, importi rritet-bie. Këto janë të gjitha të matshme dhe kanë metodologji gati-gati shkencore.

Në të ardhmen unë do të kërkoja nga institucioni juaj se si ka performuar administrata në mbledhjen e të ardhurave dhe, nga anën tjetër, me një metodologji të saktë, sepse është e lehtë të hedhësh baltë ose të mburresh, por institucioni dhe Kuvendi të bënë atë që duhet.

E dyta, për sa u përket shpenzimeve, besoj se do të ulemi bashkë të punojmë për më shumë metodologji dhe më shumë planifikim, prandaj do t'ju kërkoja cilësinë e shpenzimeve publike. Pse? Sepse të gjitha shpenzimet publike janë 28,9%.

Ju referuat, në këndvështrimin tim, jo shumë të drejtë, por, gjithsesi, shifrat janë shifra, që deficitin është 1,6 brenda zyrtarit, për shkak të rënies së të ardhurave dhe uljes së shpenzimeve. Çdo të thotë ulje e shpenzimeve? Në këndvështrimin e KLSH-së, ulja e shpenzimeve duhet të jetë realizim shpenzimesh, jo ulje shpenzimesh, sepse Ministria e Financave nuk ka mundësi të ulë shpenzimet nëse ato ndjekin natyrshmërinë e tyre gjatë vitit, 3-mujor në 3-mujor. Çdo të thotë? Nëse ministrinë apo njësitë shpenzuese kanë arritur të prokurojnë gati 95% deri në fund të muajit tetor, ministria duhet t'i ndalojë prokurimet në datën 15 tetor. Apo nuk është kështu?

Pjesa tjetër është *business usal*, më falni që e them kështu, pra, janë shpenzimet normale mujore, sepse ju i keni reflektuar drejt. Po të shikoni muajin dhjetor, ka 1,8 herë më shumë, që nuk është normale, por nuk është gërrshërë. Nga Ministria e Financave ka një detyrim me ligj. Ministria nuk bën studime fizibiliteti, nuk bën projekte infrastrukture të çfarëdollojshme, por ministria ruan deficitin, bën politikat fiskale; është autoriteti fiskal, që ruan borxhin. Besoj se ju si institucion, që, për hir të së vërtetës, keni qenë shumë dinjitoz në përqasje me financat publike dhe me Ministrinë e Financave, shpresoj ta ruani, duhet të fokusoheni, të përmirësoni edhe veten, si institucion, edhe Ministrinë e Financave si institucion, por edhe ligjvënësin, le të themi, si institucion.

Ju falënderoj!

Po, zoti zëvendësministër!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Donit të bënit ndonjë koment?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, është kënaqësi!

Lindita Milo (Lati) – Në fakt, ju keni absolutisht të drejtë në këndvështrimin tuaj pikërisht për elementet se si duhet të merren në konsideratë qoftë edhe ato fakte të pakta, por që procesi i auditimit në tërësinë e tij është pikërisht syri dhe veshi i legjislativit ndaj ekzekutivit, si dhe një nga instrumentet e qeverisjes së korporatës.

Ne jemi pikërisht për të thënë: kujdes!

Edhe fëmijës së vogël po t'i thuash: “Kujdes!”, fillon dhe irritohet.

Ju kërkoj ndjesë për shprehinë që përdora, por puna jonë e tillë është, që ne të evidentojmë çdo element dhe t'i japim peshën specifike, që e ka vetë çdo element, por absolutisht kjo kërkon një bashkëpunim të tejskajshëm për të identifikuar dhe për të mirëkuptuar të gjitha elementet dhe mesazhet që ne kërkojmë të përcjellim.

Faleminderit shumë për mirëkuptimin!

Arben Ahmetaj – Zonja Lati, do ta kthejmë në një vendimmarrje çështjen e rekomandimeve, sepse unë vazhdimisht në punën time në qeveri, por edhe këtu, i kam lexuar rekomandimet e KLSH-së. Dua ta kthejmë në një manual, sepse do t'u vlejë të gjitha institucioneve publike dhe të gjitha njësive shpenzuese.

Zoti Zëvendësministër, faleminderit për prezencën tuaj! Është kënaqësi si gjithmonë.

Elton Haxhi – Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Buxheti i vitit...

Arben Ahmetaj – Do t'ju lutesha edhe juve që të jeni konçiz, siç ishte zonja Lati.

Elton Haxhi – Madje do të jem më tepër se aq.

Buxheti i vitit 2018 mundësoi arritjen e disa objektivave thelbësorë të tillë, si: konsolidimi i stabilitetit makroekonomik dhe fiskal, nëpërmjet reduktimit të deficitit, borxhit publik dhe ruajtjes së një balance primare pozitive në zbatim të plotë edhe të rregullave fiskalë; një politikë fiskale optimale me efekt të rëndësishëm në përsheptimin e rritjes ekonomike dhe rritjes së punësimit; mbështetje e vazhdueshme buxhetore ndaj sektorëve prioritarë të tillë, si: arsimi, shëndetësia, bujqësia dhe infrastruktura; konsolidimi i një sistemi të shëndetshëm të menaxhimit financiar dhe implementimi i ligjit “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe fillimi i zbatimit të tij, një hap cilësor përpara në drejtim të përmirësimit ndjeshëm të menaxhimit të financave publike në nivel vendor.

Në terma më të prekshëm, buxheti i vitit 2018 bëri të mundur që çdo politikë e re buxhetore financiare të reflektonte opinionin e publikut, të biznesit dhe të shoqërisë civile; shtresat në nevojë të kompensoheshin nëpërmjet skemave sociale më transparente dhe

ekonomike, si dhe paketave të solidaritetit të qeverisë në mbështetje të tyre; arsimi, si prioritet, të fokusohet drejt atij profesional, me qëllim sigurimin e një lidhjeje më të mirë ndërmjet tregut të punës dhe arsimit të brezit të ri; shëndetësia të ofronte shërbime publike më cilësore nëpërmjet sigurimit të një mbështetjeje të veçantë ndaj shërbimit spitalor; fermerët të përfitonin subvencione buxhetore në përputhje me nivelin e prodhimit bujqësor të realizuar prej tyre dhe rritjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, si dhe rritjen e investimeve në nivel vendor.

Ndërkohë, për sa u takon zhvillimeve kryesore makroekonomike dhe parametrave kryesorë të qëndrueshmërisë të financave publike gjatë vitit 2018, ajo që evidentohet qartë dhe që dëshiroj ta nxjerr në pah është se viti 2018 tregoi ritme pozitive dhe përshpejtuese të rritjes ekonomike: rritja vjetore e produktit të përgjithshëm bruto arriti në 4,1% në vitin 2018, nga 3,8% që ishte një vit më parë, duke shënuar rritjen më të lartë vjetore që nga viti 2008; rritja ekonomike u gjenerua nga kërkesa e brendshme si konsumi, ashtu edhe investimet; konsumi total u rrit me 2,4% në terma realë, konsumi privat u rrit me 3,04% në terma realë, gjithashtu investimet totale, prodhimi i kapitalit fiks bruto gjatë vitit 2018 u rritën me rreth 2,7%. Tregu i punës reflektoi zgjerimin e vazhdueshëm ekonomik. Në fund të vitit 2018 shkalla e papunësisë ra në 12,3%. Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore vazhdoi të rritet, duke arritur në 68,7%, krahasuar me 67,4%, që ishte në tremujorin e katërt të vitit 2017.

Bilanci i përgjithshëm fiskal ka shënuar nivelin minus 1,6% të produktit të brendshëm bruto, duke u përmirësuar me rreth 3,2 pikë përqindje nga viti 2014 në vitin 2018. Që nga viti 2016 kemi arritur një bilanc primar pozitiv prej 0,6% të produktit të brendshëm bruto, krahasuar me një deficit primar prej minus 2,3% që ishte në vitin 2014. Balanca korrente, e definuar si diferenca ndërmjet investimeve publike dhe deficitit vjetor, apo rregulli i artë, në vitin 2018 arriti nivelin 3,1% të produktit të brendshëm bruto dhe synohet të arrijë nivele më të...

Arben Ahmetaj – Ka qenë ndonjëherë më lart?

Elton Haxhi – Jo.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Elton Haxhi – Asgjë.

Lidhur me stabilitetin makroekonomik, politika fiskale konsoliduese ka synuar të mbajë trajektoren e rënies së borxhit publik në raport me prodhimin e brendshëm bruto që nga viti 2016. Bilanci i përgjithshëm fiskal është përmirësuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kemi arritur një bilanc primar pozitiv. Të ardhurat tatimore janë rritur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Më falni, zoti Zëvendësministër!

Ju lutem, deputetë, qetësi, në respekt të Ministrisë së Financave!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, zoti Bushati, papërmbytshmëria juaj duhet të kufizohet brenda rregullave të komisionit!

Elton Haxhi – Faleminderit!

Pra, të ardhurat tatimore janë rritur ndjeshëm gjatë viteve të fundit, nga 22,2% në vitin 2013, në 26% në vitin 2018 në raport me prodhimin e brendshëm bruto, nxitur nga politika tatimore dhe përmirësimi i administratës tatimore.

Reforma kundër informalitetit, gjithashtu, ndihmoi në rritjen e mbledhjes së të ardhurave, duke mbetur një prioritet i vazhdueshëm i kësaj qeverie.

Gjithashtu, për sa i përket menaxhimit të borxhit, gjatë këtyre viteve kemi zvogëluar risqet e ndryshimit të termave duke diversifikuar dhe duke zgjatur ndjeshëm maturitetin e borxhit tonë.

Konsolidimi fiskal dhe reduktimi i borxhit publik janë thelbësorë për të ulur dobësitë e lidhura me borxhin që pengon rritjen dhe shkakton paqëndrueshmëri makroekonomike. Për të reduktuar dobësitë e lidhura me borxhin publik, janë ndërmarrë disa masa për rregullimet fiskale gjatë viteve të fundit. Kjo politikë e ndjekur solli si rezultat edhe suksesin me eurobondin.

Referuar ecures së borxhit publik, ky i fundit në vitin 2018 ra në nivelin 68% të produktit të brendshëm bruto, duke vijuar trajektoren rënëse për të tretin vit radhazi dhe duke mundur një reduktim më optimal, por të konsolidueshëm nga niveli 72,75 në vitin 2015.

Në aspektin e borxhit publik neto, nga asetet likuide të qeverisë, depozitat në para të qeverisë që mbahen në bankën qendrore, rënia shënoi 8 pikë përqindje vetëm për tre vjetët e fundit, duke arritur në nivelin 64,8% nga rreth 71,9%, që ishte në vitin 2015.

Të ardhurat e buxhetit të vitit 2018. Të ardhurat totale të buxhetit të konsoliduar për periudhën 12-mujore të vitit 2018 arritën 449,5 miliardë lekë me një realizim në masën 97,3% të planit, kjo sipas aktit normativ nr. 2. Krahasuar me vitin 2017, ky zë ka rezultuar 4,4% ose 19,1 miliardë lekë më shumë.

Rritja e kontributit të të ardhurave të buxhetit të shtetit për vitin 2018, krahasuar me vitin paraardhës, është tregues i rëndësishëm i përmirësimit të performancës së mbledhjes së të ardhurave në kuadër të reformës së konsolidimit të financave publike. Kjo rritje vjen kryesisht nga impakti i rritjes ekonomike dhe nga përmirësimi në administrimin e taksave.

Në terma nominalë, të ardhurat e përgjithshme janë rritur në mënyrë të qëndrueshme nga viti në vit. Në vitin 2018 të ardhurat publike arritën 27,6% ose 1% më shumë se mesatarja e pesë vjetëve të fundit.

Të ardhurat tatimore, ku përfshihen të ardhurat nga tatimet dhe doganat...

Arben Ahmetaj – Më falni, që ju ndërpres, por duhet ta theksoni, zoti Zëvendësministër, pa asnjë taksë të rritur!

Elton Haxhi – Po.

Arben Ahmetaj – Sepse edhe në relacion nuk keni bërë vlerësime.

Elton Haxhi – Përkundrazi, duke e ulur.

Arben Ahmetaj – Pse nuk e thoni, apo duhet ta them unë?

Elton Haxhi – Të ardhurat tatimore (ku përfshihen të ardhurat nga tatimet dhe doganat, të ardhurat nga pushteti lokal dhe të ardhurat nga fondet speciale) për periudhën 12-mujore arritën në vlerën 419,3 miliardë me një realizim ndaj planit vjetor në masën 99% dhe me rritje kundrejt vitit të kaluar në masën 5,2% ose në vlerën 20,7 miliardë lekë.

Të ardhurat nga pushteti vendor u realizuan në masën 21,9 miliardë lekë, rreth 16%, ose 3 miliardë më shumë se të ardhurat e planifikuara për vitin 2018 dhe 3,4 miliardë lekë ose 18,5% më shumë, krahasuar me të ardhurat e vitit 2017.

Të ardhurat nga fondet speciale rezultuan në vlerën 93,2 miliardë lekë me një realizim ndaj planit fillestar në nivelin 105,8% ose 5,1 miliardë më shumë dhe 6,4 miliardë lekë ose 7,3% më shumë se një vit më parë.

Shpenzimet buxhetore. Zbatimi i buxhetit të shtetit në kohë dhe në respekt të përcaktimeve ligjore është instrument stimulues kyç për aktivitetin ekonomik të shtetit në tërësi, që ndikon direkt në performancën e ekzekutimit të shpenzimeve publike. Buxheti i vitit 2018 ka financuar 127 programe buxhetore dhe ka synuar realizimin e 819 produkteve të 11 ministrive të linjës dhe fondeve speciale. Gjithashtu, këto shpenzime kanë financuar edhe buxhetin e 61 bashkive dhe 12 qarqeve.

Në vija të përgjithshme, nga procesi i monitorimit për vitin 2018, të kryer nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nga 819 produkte të parashikuara për vitin 2018 janë realizuar plotësisht dhe pjesërisht rreth 759 produkte ose 92,7% e tyre.

Shpenzimet e përgjithshme publike për vitin 2018 arritën në rreth 476,1 miliardë lekë me një realizim në masën 95,8% të planit vjetor, sipas buxhetit fillestar, ose 90,6 pikë 3% të planit sipas aktit normativ nr. 2.

Shpenzimet e përgjithshme për vitin 2018 përbëjnë 28,86% të produktit të brendshëm bruto, duke ruajtur një nivel të qëndrueshëm ndër vite kundrejt këtij produkti dhe një nivel mesatar rreth 30%.

Referuar shpenzimeve sipas sektorëve, sektori me peshën më të lartë në shpenzimet buxhetore është mbrojtja sociale me 32% të shpenzimeve të përgjithshme publike, e dominuar nga shpenzimet për fondin e pensioneve, si dhe programe në mbështetje të familjeve dhe individëve në nevojë. Arsimi dhe shëndetësia përbëjnë përkatësisht 11% dhe 10% të këtyre shpenzimeve për vitin 2018. Çështjet ekonomike dhe strehimi, ku përfshihen infrastruktura rrugore, ujësjellësit dhe kanalizimet, mbetjet urbane dhe planifikimi urban, zënë përkatësisht 11% dhe 10% të shpenzimeve të përgjithshme për vitin 2018.

Shpenzimet e përgjithshme publike përbëjnë 18% të buxhetit të vitit 2018, përfshirë edhe pagesat e borxhit.

Shpenzimet korrente dhe ato kapitale kanë shënuar një realizim të kënaqshëm, respektivisht në masën 97,4% dhe 91% të planit fillestar, si dhe 97,3% dhe rreth 93,2% të planit të rishikuar për vitin 2018 me një deficit faktik prej rreth 26,2 miliardë lekësh.

Fondet buxhetore të alokuara për investime kanë prekur fushat më të rëndësishme të ekonomisë, si: infrastrukturën, arsimin, shëndetësinë, turizmin, rendin dhe sigurinë publike.

Realizimi i investimeve në total ka qenë në nivele të larta, veçanërisht për financimin e brendshëm.

Buxheti vendor është shoqëruar me një model të ndryshimit të financimit dhe menaxhimit financiar në qeverisjen vendore, në funksion të thellimit të zbatimit të reformës administrativo-territoriale.

Ndër arritjet kryesore të kësaj reforme, të shoqëruara me efekte pozitive në buxhetin vendor të vitit 2018, mund të përmendim se buxheti vendor i vitit 2018 në tërësi është 7% më i lartë sesa ai i vitit 2017 ose 3,1 miliardë lekë më shumë; transferta e pakushtëzuar, që është 1% e produktit të brendshëm bruto, ka rritur gjatë vitit buxhetor 2018, në mënyrë të ndjeshme, të ardhurat dhe stabilitetin e fondeve të disponueshme për qeverisjen vendore; ka rritje të transfertës së pakushtëzuar në 16,5 miliardë lekë nga 13,5 miliardë lekë, që ishte në buxhetin e vitit 2017, pra 3 miliardë lekë më shumë ose rreth 22% më e lartë se në vitin 2017; ka arritur përmirësimin e kapacitetit fiskal të financave vendore, si dhe çoi në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në masën 24,2 miliardë lekë ose 3,9 miliardë lekë më shumë, që është 23% më e lartë se viti 2017.

Ecuria e reformës së menaxhimit të financave vendore. Janë fokusuar si në thellimin e decentralizimit fiskal, duke riparë të gjithë skemën e të ardhurave të pushtetit vendor, ashtu edhe anën e shpenzimeve publike vendore, pra menaxhimin e financave publike në nivel vendor. Në këto kushte, është punuar ngushtësisht me njësitë e qeverisjes vendore, me qëllim jo vetëm plotësimin e kuadrit ligjor, por edhe në drejtim të implementimit sa më të suksesshëm nga këto njësi.

Nuk po i përmend përsëri dy aktet normative të ndryshimit të buxhetit të vitit 2018, aktin normativ nr. 1 dhe nr. 2, të cilët, pa hyrë në shumë detaje, siguruan një shpërblim për pensionistët dhe familjet në nevojë në fund të vitit; rritën eficiencën e përdorimit të burimeve publike ndërmjet rialokimit drejt projekteve të investimeve me progres të mirë, si dhe pastruan rreth 2,2 miliardë lekë nga detyrimet e prapambetura.

Është me rëndësi të theksohet që ndryshimet e propozuara...

Arben Ahmetaj – Më falni, se nuk dua ta harroj, keni planifikuar bonus për pensionistët këtë vit?

Elton Haxhi – Me buxhetin po punohet.

Arben Ahmetaj – Jo, buxhetin, por draftbuxheti është duke u punuar. Buxheti është punuar.

Elton Haxhi – Është duke...

Arben Ahmetaj – Keni planifikuar, zonja...? Jo?

Por komisioni do t'ju kërkojë që të jepni të njëjtin bonus si vitin e kaluar. Nuk do të duhet të ulet bonusi, në krahasim me vitin e kaluar. Bonusi për pensionistët është i rëndësishëm, madje ky komision do ta kërkojë nga qeveria.

Do të duhet që ta planifikoni dhe ta menaxhoni, në mënyrë që pensionistët të përfitojnë bonus siç ka ndodhur katër vjet rresht: 2014-2018. Pastaj, për rritjen e rrogave, të pagave, besoj se do të diskutojmë gjatë draftimit të buxhetit për vitin 2019. Por bonusi për Vitin e Ri dhe për Krishtlindjet, në varësi të çfarë festojmë, besoj se është i shenjtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Zëvendësministër...

Elton Haxhi – Mundem të bëj edhe një koment të shkurtër?

Arben Ahmetaj – Është kënaqësi, ju lutem, si gjithmonë!

Elton Haxhi – E kam në lidhje me KLSH-në, i cili, si një institucion i pavarur dhe kushtetues, ka gjykimin e tij dhe ne e respektojmë atë. Madje në këtë bashkëpunim unë do të doja të theksoja që ne kemi ngritur edhe një sekretariat të përbashkët, i cili ka për synim pikërisht shqyrtimin e të gjitha rekomandimeve që ka lënë KLSH-ja, sidomos ato sistemike dhe adresimin e tyre në mënyrë të qartë dhe me një metodologji të qartë edhe për njësitë zbatuese. Megjithatë, për shumë nga rekomandimet unë do të doja të theksoja që Ministria ka bërë observacionet e saj dhe për një pjesë të mirë të tyre ka hartuar edhe plane veprimi, të cilat do t'i zbatojë në vijim.

E falënderoj KLSH-në për të gjithë kontributin që ka dhënë në rekomandime, pasi qëllimi final i KLSH-së apo i një auditimi është përmirësimi dhe jo thjesht konstatimi. Kështu

që ne mbetemi të hapur për këtë bashkëpunim dhe besoj që së shpejti do të kemi një adresim të rekomandimeve sistematike.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Zëvendësministër!

Kam një vërejtje. Besoj që në relacion ka nevojë për konkluzione. Pra, relacioni shoqëruar i buxhetit faktik ka nevojë për konkluzione duke iu referuar arritjeve, mosarritjeve, reformave, madje duhet edhe një komentim krahasues statistikor dhe jo vetëm i shifrave. Pra, në qoftë se ka kaq arritje sa thatë ju, balanca korrente si kurrë më parë 3,3%, më korrigjo Endrit; deficitin rekord, minus 1,6%; të ardhurat tatimore rekord, 26,2%, nëse nuk gabohet, zoti Niko, e prodhimit të brendshëm bruto; në qoftë se balanca primare është më e larta në katër vjetët që kemi filluar të prodhojmë balancë primare; në qoftë se borxhi ka ardhur në ulje; në qoftë se brenda llogarisë së qeverisë në datën 31 dhjetor u janë lënë shpenzimeve mbi 200 milionë euro, të cilat në buxhetin faktik numërohen si borxh, ndërsa në praktikë nuk janë borxh, sepse ato zbrazin automatikisht atë që quhet llogaria e qeverisë; në qoftë se ka pasur një eurobond aq të rëndësishëm, të domosdoshëm dhe në këndvështrimin e institucioneve ndërkombëtare, se IMI nuk numërohet në këtë rast, kaq të suksesshëm; në qoftë se ka pasur rritje ekonomike 4,06% (“katërfish”, tha relatorja, krahasuar me vitin 2013); në qoftë se ka pasur përmirësim shërbimesh në disa elemente; në qoftë se buxheti social është rekord 32%; në qoftë se nuk ka pasur rritje taksash, të gjitha këto duhet të jenë konkluzione të relacionit, sepse i shërbejnë publikut, por edhe neve si deputetë të thjeshtë për të gjykuar qoftë relacionin dhe raportin që sjell KLSH-ja, qoftë buxhetin faktik, qoftë arritjet dhe mosarritjet apo edhe një element tjetër, që po paraprijnë diskutimet për draftbuxhetin e vitit 2020. Të gjitha këto janë shumë të rëndësishme, ndërkohë që pjesa tjetër është ajo që i thashë edhe Kontrollit të Lartë të Shtetit, se Ministria e Financave është autoriteti fiskal dhe, me ligj, është menaxhuesi i buxhetit të shtetit. Buxheti është i parlamentit, është i qytetarëve.

(Diskutime pa mikrofon)

Pra, atë që i kërkoja KLSH-së do t’ju kërkoj edhe juve. Duhet të bëni një agjendë rekomandimesh, sepse, në finale, përmirësimi i financave publike është strukturor dhe legjislativ, por është procedural, ku procedurat i keni ju në dorë. Ndërkohë, dua t’ju ndihmoj për të presuar, në legjitimitetin tuaj, së bashku me Kontrollin e Lartë të Shtetit, të gjitha institucionet tjera. Brenda kësaj, dua t’ju kërkoj që të bashkëpunoni me KLSH-në dhe të përqasni filozofinë e strategjisë së menaxhimit të borxhit, ku në një moment zonja Lati iu referua. Pra, ndryshe e shikon KLSH-ja, ndryshe e shikoni ju dhe ndryshe mund ta shohim ne, por tani ne nuk po hyjmë në këtë debat apo diskutim, thjesht po kërkojmë që këto të shihen dhe besoj se brenda të gjithë kësaj pakete rekomandimesh të dilni edhe me detyrime

për ndryshime ligjore, në mënyrë që ne t'ju mbështesim sa më shpejt dhe sa më efektivisht që të jetë e mundur.

Zoti Zëvendësministër, ju falënderoj!

Dua ta theksoj prapë domosdoshmërinë e bonusit për pensionistët. Vitin e kaluar ne kemi dhënë, nëse nuk gabohem, rreth 4 miliardë, Moza më korrigjo! Ju lutem, brenda menaxhimit ekselent që bëni, të planifikoni sot, të paktën 3,3 miliardë bonus për pensionistët, në mënyrë që pensionistët të gëzojnë, siç gëzuan edhe vitin e kaluar, edhe këtë vit nga bonusi që u takon.

Për sa më përket mua, pasi ju jeni punonjës administrate, ne e kemi shënuar edhe në ato angazhime politike dhe publike që çdo vit pensionistët dhe familjet në nevojë do të marrin shpërblim në fund të vitit. Po të më pyesni se për çfarë do ta marrin shpërblimin, përgjigja ime është se na duan kur bëjmë reforma, na durojnë kur bëjmë gabime dhe kanë nevojë, siç është shënuar në ligjin specifik, për t'i axhustuar të ardhurën, që e kanë në pamundësi të tyre, më të ulët se qytetarët e tjerë të punësuar. Ju lutem, parashikojeni bonusin për pensionistët!

Po lexoj se gjatë paradites ka ardhur edhe akti normativ dhe jam i bindur që në aktin normativ keni planifikuar bonus për pensionistët. Jam shumë i bindur për këtë.

Faleminderit!

Edlira Hyseni – Përsëndetje, unë jam Edlira Hyseni, me profesion audituese e pavarur, por këtu jam deputete!

Në radhë të parë, dua ta nis fjalën time me atë që tha kryetari, i cili i mëshon shumë bonusit dhe jam shumë dakord, por shpresoj të ketë ndonjë ide për të rritur pensionet, pastaj t'i kënaqim edhe me bonus. Kjo pjesa e bonusit më duket pak reduktive, por për këto ndoshta duhet të flasim në draftin e vitit 2019.

Është hera e parë që marr pjesë në një diskutim lidhur me buxhetin e shtetit, sepse kam qenë anëtare e këshillit bashkiak Durrës dhe jam me marrë buxhetin e Bashkisë së Durrësit dhe një nga problematika që isha gjithmonë prezente në mbledhje ishte koha në dispozicion për të dhënë një opinion. Në profesionin tim të auditueses, por mendoj edhe të kolegëve që janë prezent, domosdoshmëria për të ditur se për çfarë flasim apo për të dhënë opinion kërkon kohën dhe mundësinë që të informohesh, të shohësh, pastaj të japësh një mendim. Ne kemi përpara sot, mendoj se është një nga projektligjet më të rëndësishme, dy raporte, ku në njërin anë kemi raportin me doza të forta sheqeri, nga i cili të shfaqet diabeti, lidhur me opinionin për pasqyrat financiare apo buxhetin e vitit 2018, i cili është i anës qeverisëse dhe në anën tjetër kemi 400 faqe raportin e KLSH-së që, siç zonja raportoi, ka gjetjet e tij.

Në radhë të parë, unë nuk e di nëse ky raport i KLSH-së është për të gjithë apo është vetëm për mua, sepse ai mban datën 10 tetor, pra, ditën e sotme, dhe nuk e di nëse kolegët kanë pasur mundësi ta shfletojnë, ta lexojnë apo ta analizojnë. Deputetja relatore iu referua edhe gjetjeve të këtij raporti, që do të thotë se mund ta ketë pasur më parë në dispozicion raportin e KLSH-së, por unë nuk e kam pasur. Prandaj mendoj se për një vendim kaq të rëndësishëm, të diskutojmë buxhetin qoftë në anët e mira, qoftë në anët e këqija, ku për të parë pasqyrat dhe relacionin e sjellë me 100 faqe, na kanë lënë vetëm dy-tri ditë kohë dhe për raportin e sotëm tuajin unë e kam të pamundur të jap një opinion. Nëse kjo mbledhje vlen për të dhënë një deklaratë politike apo për të folur për sukseset e qeverisë apo çfarë doni ju, atëherë ne opozita, nuk e di nëse kolegët e tjerë kanë pasur kohë të formulojnë një opinion më profesional, unë, personalisht, me kaq shumë materiale për një vendim kaq të rëndësishëm, i cili ka 2-3 ditë që ka ardhur nga qeveria, është ajo pjesa e diabetit, dhe kjo e KLSH-së e ardhur sot, e kam të pamundur të formuloj një opinion.

Për ta përmbledhur pak fjalën time, dua t'i drejtoj dy pyetje zonjës, e cila përfaqëson KLSH-në.

Në radhë të parë, në këtë raportin e gjatë që keni bërë, për të cilin shpresoj të jetë në interes të të gjithëve për t'u lexuar, sepse unë e komplimentoj punën e madhe që ka bërë stafi juaj për të arritur...

Arben Ahmetaj – Ju lutem, bëni pyetjen!

Edlira Hyseni – Auditimi është një proces i rëndësishëm. Ju lutem, po komplimentoj punën që është bërë dhe e vlerësoj.

Pyetja e parë. Të gjitha gjetjet që ju pak shkurt dhe të përmbledhura i referuat, a janë të përmbledhura apo janë në kapituj të ndarë sipas argumenteve që janë trajtuar?

Pyetja e dytë. Ju sot nuk e thatë, ose ndoshta unë nuk e kam dëgjuar, por dua të di nëse ju keni shprehur një opinion, sigurisht që në vitet e tjera ju keni pasur të tjera gjetje dhe të tjera rekomandime, atë që kryetari iu referua për manual, por nuk ka rëndësi, sepse audituesi sugjeron dhe gjen gjetjet, pastaj detyra e qeverisë është t'i zbatojë dhe të kthejë në praktikë ato, për gjetjet e vitit të kaluar, në ç'masë janë realizuar ato dhe si janë konkretizuar ato?

Pyetja e fundit. Nuk e di nëse është i shprehur në raport, sepse unë nuk e kam lexuar raportin, pasi sot më ka ardhur në tavolinë, por dua të di nëse në opinionin tuaj përfundimtar, opinionin juaj mbi auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara të shtetit për vitin 2018 është një opinion pa rezervë, me rezervë apo me çështje për diskutim? Pra, cili është konkluzioni i opinionit tuaj final përtej gjetjeve që keni detajuar?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj-Zonja Lati, ju lutem në mënyrë sa më koncize!

Lindita Milo (Lati) – Ju falënderoj shumë për mirëkuptimin në substancë të elementeve teknike nga pikëpamja e auditimit, sikurse edhe për vlerësimin që bëtë për punën e KLSH-së!

Absolutisht çdo fjalë, çdo shifër dhe çdo presje që unë përmenda në këtë prezantim shumë të shkurtuar gjendet pak më e zgjeruar në përmbajtje dhe pastaj çdo gjë gjendet në kapitujt e veçantë, ku ka elemente detajuese, me teste dhe elemente të tjera.

Kontrolli i Lartë i Shtetit është shprehur në opinion dhe, në faqen e parë pas hyrjes, në faqen e dytë, gjendet opinioni dhe po ta shikoni, ai i jep të gjitha elementet. Ne flasim për sisteme dhe, në kushtet kur flasim për sisteme dhe probleme, sikurse i përmendi zoti zëvendësministër, ato janë pjesërisht të adresuara, ose në adresim e sipër, gjë që do të thotë se të dyja palët janë duke adresuar elementet sistemike, të cilat do të çojnë në një përmirësim të qëndrueshëm të atyre elementeve, që nisin si elemente teknike, por në fund fare cenojnë sistemet.

Në lidhje me gjetjet e vitit të kaluar, ne, kur japim opinionin, kuptohet që në vite të ndryshme kapim disa aspekte të veçanta në përputhje me atë qëllim që vendos audituesi, duke vendosur peshën specifike ndaj elementeve të ndryshme për sa u përket problematikave të shpenzimeve. Ne jemi shprehur kur kemi pasur përmirësime, siç u shpreha edhe për rastin e APP-së, ku u evidentua një fenomen për mungesën e filtrave dhe u informuam për këtë. Pra, kjo do të thotë se qëllimi i këtij raporti nuk është që të bëjmë krahasimin me gjetjet e vitit të kaluar, sepse për elemente, të cilat ne i cilësojmë themi nëse është një gjetje e vijueshme, e marrë në konsideratë apo se cilat elemente të tjera duhet të merren në konsideratë. Kështu që raporti është komplet ezaurues në të gjitha dimensionet e veta.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Lati!

Po, zonja Gjylameti.

Blerina Gjylameti – Shumë shkurt.

Së pari, dua t'u sugjeroj kolegëve të opozitës që, nëse jemi në seksionin e pyetjeve, duhet të bëjmë pyetje dhe më pas të mbajmë qëndrime, në mënyrë të tillë që të mos paragjykojmë të gjithë procesin. Nëse e fillojmë diskutimin me: “Mungon kjo, kjo...” dhe mungesa e eksperiencës në analizën e buxhetit faktik na çon në paragjykim, unë mendoj se do të ishte më mirë të bëjmë pyetjet dhe më pas të mbajmë qëndrimet politike apo opinionet për të gjithë seancën.

Së dyti, mendoj se për sa kohë ajo që po diskutojmë sot ka të bëjë me buxhetin faktik, do të thotë post faktum (ajo çfarë ka ndodhur), ne duhet të analizojmë atë çfarë ka ndodhur,

pa dashur të bëjmë atë që u tha, reklamën, arritjet dhe dështimet, por, mbi të gjitha, gjetjet, në mënyrë të tillë që më pas, edhe në buxhetin e ardhshëm, t'i adresojmë të gjitha problematikat që kanë hasur dhe të mos kemi probleme të tilla. Reklamimi i punës të të gjitha institucioneve përkthehet në gjëra konkrete që kanë të bëjnë me qytetarët. Prandaj mendoj se, kur flasim për rritje ekonomike, kur flasim për rritje të të ardhurave, duke mos shtuar taksat, dhe kur flasim për rritje të të ardhurave, të cilat përkthehen në rritje të punësimit, në rritje të investimeve publike dhe në rritje të investimeve, të cilat janë të financuara nga buxheti i shtetit, të gjitha këto janë lajme shumë të mira për ato që na dëgjojnë.

Për sa i përket pjesës së informacionit dhe të raportit që KLSH-ja ka sjellë për buxhetin faktik, i gjithë informacioni është zyrtar, të gjithë e kemi dhe na shërben për të arritur të krijojmë një opinion dhe, në fund, në bazë të këtij informacioni, kjo të përkthehet në një votim pro ose kundër në komision. Ne që kemi disa kohë në parlament e dimë, por besoj edhe ju, nuk është mëkat të kesh mungesë eksperience, Kontrolli i Lartë i Shtetit raporton ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Zonja Blerina, më fal pak!

Ju lutem, zonjë, mos ndërhyini, sepse nuk do të arrini të flisni! Unë i ndaloj ata që të ndërhyjnë, kështu që edhe ju mos ndërhyini, sepse bëhet pazar këtu.

Blerina Gjylameti – E kam konstruktive dhe vazhdoj ta kem konstruktive. KLSH-ja raporton çdo vit mbi gjetjet dhe rekomandimet që ka. Në atë seancë ne mund të pyesim për të gjitha gjetjet dhe rekomandimet, në mënyrë të tillë që të kuptojmë se sa prej rekomandimeve që ka bërë KLSH-ja janë reflektuar në ndryshim nga institucionet publike shqiptare. Në mënyrë të posaçme ne flasim për raportin e buxhetit faktik, gjetjet që kemi dhe, mbi të gjitha, ajo çfarë do të na duhet të gjithëve, si deputetë, në mënyrë që edhe kur t'i drejtohem seancës për miratim, të duhet të kemi në fokus të posaçëm mirëmenaxhimin e financave publike dhe në mënyrë të posaçme qytetarët.

Ndaj, edhe një herë, kryetar, këtë e kam kërkesë të përsëritur, nëse kemi seancë pyetjesh, duhet të bëjmë pyetje, nëse kemi qëndrime, kalojmë te qëndrimet dhe opinionet.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Me gjithë procedurën, i mirëkuptojmë edhe kur i përziejmë ndonjëherë pyetjet me komentet. Kjo është edhe çështje eksperience, sepse askush nga ne nuk ka qenë i ditur...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, merreni me qetësi, sepse...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Roshi, ju lutem, me qetësi, mbani qëndrimet tuaja dhe pyetjet tuaja, sepse buxheti është i qytetarëve dhe në fund edhe KLSH-ja, edhe Ministria e Financave janë autoritete publike që po raportojnë. Raporti është i detajuar nga të dy institucionet. KLSH-ja ka bërë një raport të detajuar pikë më pikë, Ministria e Financave ka qëndrimin e vet për raportin, relacionin (te relacioni lë pak për të dëshiruar) dhe tabelat.

Vazhdojmë me pyetjet dhe komentet. Ju lutem, sa më koncizë, sepse po flasim për buxhetin faktik dhe në seancë kemi mundësi të mbajnë edhe qëndrimet tuaja patjetër.

Po, zonja Dhima.

Antoneta Dhima – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit përfaqësuesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe të Ministrisë së Financave për prezantimin e punës, pasi angazhimi juaj dhe i të gjithë stafeve është një punë 1-vjeçare!

Kam dy pyetje për përfaqësuesen e KLSH-së. Objekti i punës suaj është zbatimi i rekomandimeve, masave administrative, si dhe masave të vlerësimi të dëmit. Gjatë vitit 2018, nga kontrollet që ju keni ushtruar, a janë zbatuar këto rekomandime, a janë reflektuar nga ana e institucioneve dhe a raportohet rregullisht pranë institucionit tuaj?

Pyetja e dytë është edhe për ju, edhe për Ministrinë e Financave. Menaxhimi i financave publike është shumë i rëndësishëm dhe është detyrim i të gjitha institucioneve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor. Në raportin e Ministrisë së Financave një vend të veçantë zë menaxhimi i të ardhurave të pushtetit vendor dhe theksohet se niveli i menaxhimit të financave publike në pushtetin vendor është i ulët në kohën e ish-komunave dhe, njëkohësisht, janë evidentuar dobësi në mbledhjen e të ardhurave dhe administrimin e tyre në kryerjen eficient të shpenzimeve, në mbajtjen e kontabilitetit publik dhe evidentimi i një stoku të lartë të detyrimeve të prapambetura. Nga kontrollet që ju keni ushtruar gjatë vitit 2018, krahasuar me kontrollet e mëparshme, a ka përmirësim të menaxhimit të financave publike në institucionet e nivelit të pushtetit vendor dhe qendror?

Faleminderit!

Lindita Milo (Lati)- Faleminderit për pyetjet!

Absolutisht që zbatimi i rekomandimeve është një nga aspektet e punës sonë, sidomos ndjekja e zbatimit të rekomandimeve, sepse, nëse duam të matim efektivitetin e punës së KLSH-së, SHPPF-ja është niveli i zbatimit të rekomandimeve. Ne prodhojmë një raport të detajuar për zbatimin e rekomandimeve çdo 6 muaj dhe ajo që dua të theksoj është fakti se ka një bashkëpunim shumë të ngushtë me Kuvendin e Shqipërisë, me departamentin që merret me monitorimin e institucioneve të pavarura, ku po ndërtohet dhe është duke u konsoliduar

një sistem shumë proaktiv për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, përfshirë këtu edhe KLSH-në.

Megjithatë, për hir të së vërtetës, është e vërtetë që rekomandimet e KLSH-së janë disi specifike dhe pa dyshim puna që do të vazhdojë në vijim, siç e përmendi edhe zoti kryetar, patjetër që do të ketë mundësinë të detajojë qartazi ato që janë rekomandime në planin më strategjik, pra ato që lidhen me ligjësi, dhe rekomandimet që lidhen me elemente teknike të mirëfillta.

Për sa i përket pyetjes suaj të dytë, unë dua ta përmbledh vetëm me një fjali. Qartazi në pjesët e raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit jepet një informacion i detajuar edhe për problematikat që hasen. Ne hasim mungesë kapacitetesh në njësitë e vetëqeverisjes vendore, pikërisht për një menaxhim me eficiencë të financave publike. Në raport ka elemente të detajuara në lidhje me prokurimin publik, në lidhje me detyrimet e prapambetura e kështu me radhë.

Ju faleminderit!

Elton Haxhi – Lidhur me kontributin që ministria ka dhënë në lidhje përpërmirësimin e menaxhimit të financave vendore, dua të përmend ligjin e ri për menaxhimin e financave vendore të vitit 2017. Gjithashtu, në strategjinë e menaxhimit të financave publike një aspekt i veçantë u është rezervuar edhe financave vendore nëpërmjet asistencës intensive ndaj këtyre njësive në aspektin e trajnimeve, hartimit të procedurave apo metodologjive. Dua të them se ka një përmirësim të ndjeshëm në aspektin e menaxhimit. Unë e kam prekur vetë pjesën e komunave në periudhën e reformës administrativo-territoriale, ku shumica e komunave kanë qenë në një gjendje të mjerueshme për sa i përket dokumentacionit kontabël.

Arben Ahmetaj – Unë dua të përmend të gjithë kontributin që ka dhënë USAID-i për sa i përket ligjit të financave vendore. Dua të falënderoj Franin, që ka bërë një punë të lavdërueshme, spektakolare. Unë vetëm e ndihmova pak në ligjin e financave vendore, por, sa për dijeni, zonja Dhima, sot ka një ligj për vetëqeverisjen vendore, për të cilin mendoj se kushtet e këtij ligji janë gati njëlloj për qeverisjen qendrore. Ajo që tha zonja Lati është themelore, mungojnë kapacitetet. Në qoftë se do të vazhdohet pafundësisht të tolerohet një reflektim jo i plotë i procedurave dhe ligjit të financave vendore të pushteti vendor, të jeni të bindur që ndër vite nuk kemi për të pasur as transparencë të plotë, siç e duam, as efektivitet të plotë, por, për shkak të këtyre të dyjave, do të cenohet edhe decentralizimi. Për këtë jam i bindur.

Faleminderit!

Po, Suzana.

Suzana Topi – Faleminderit!

Nga raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit është konstatuar se borxhi i brendshëm nga mosderdhja e TVSH-së së qeverisjes vendore është rritur. Çfarë masash keni marrë ju si Ministri e Financave për uljen e këtij borxhi?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Kush do të përgjigjet nga ju?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju kërkoj ndjesë! Cila ishte pyetja?

Suzana Topi – Nga raporti i KLSH-së u konstatua një rritje e borxhit të brendshëm për shkak të mosderdhjes së TVSH-së nga bashkitë. Çfarë masash do të merren për uljen e këtij borxhi?

Arben Ahmetaj – Jo, jo. Mos na e drejto kamerën! Meqë nuk kemi kamera, teknikisht nuk është korrekte.

Pra, nuk rritet borxhi publik për shkak të mosderdhjes së TVSH-së. Ju kërkoj pafundësisht falje nëse ju vë në siklet, por ju lutem ribëjeni pyetjen. Ndoshta, mund t'ju ndihmoj edhe zonja Lati.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka gjë. Ju lutem! Zonja Lati, nuk ka problem, sepse e kam ndjekur vetë çështjen për të cilën pyeti zonja Suzana. Nëse më lejon?

Bëhet fjalë për detyrimet e prapambetura të njërive vendore, të cilat, në konceptin teknik dhe në definicionin teknik të borxhit të përgjithshëm të qeverisë së përgjithshme, numërohen si borxh. Qeveria ka shumë pak instrumente për të detyruar bashkitë, edhe pse Ministria e Financave, sidomos Frani me Mozën, bashkë me ish-sekretaren e përgjithshme, Gelardinën, kanë bërë një punë të lavdërueshme për të ndjekur në vazhdimësi detyrimet çdo tre muaj. Këto janë katër njësi, siç iu referua zonja Lati: Tirana, që e ka të trashëguar dhe, në mos gabohem, të më korrigjojë Ministria e Financave, e ka ulur rreth 4,2 miliardë lekë borxhin e trashëguar. Apo nuk është kështu?

Borxhi i përgjithshëm është i qeverisë qendrore. Definicionin e borxhit publik, kur ne e deklarojmë zyrtarisht së bashku me FMN-në, e kemi të ndarë: është borxhi i përgjithshëm dhe borxhi i qeverisë qendrore. Brenda borxhit të qeverisë qendrore borxhi i përgjithshëm ka dy kategori, ajo që quhet “detyrimet e prapambetura”. Një kategori e detyrimeve të prapambetura është ajo që iu referua me korrektësi zonja Lati, si dhe detyrimet e prapambetura të qeverisë qendrore, që përsëri iu referua zonja Lati për TVSH – në e papaguar, e pa rimbursuar, apo për projekte investimesh, të cilat mund të kenë avancuar me punime, por nuk kanë marrë pagesën e situacioneve ose nuk kanë ...

Këtu bëjmë debat midis Ministrisë së Financave dhe KLSH-së se cili është definicioni, kur ndërpritet numërimi, kontabilizimi e të tjera. Nuk e di sa arrita të të përgjigjem dhe të të sqaroj, por nëse dikush do të shtojë ndonjë gjë, mund ta marrë fjalën.

Po, Moza.

Mimoza Dhëmbi – Në zbatim të një strategjie, që ne kemi miratuar që në vitin 2015, “Për ndjekjen, parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, detyrimet e njësive vendore monitorohen çdo tremujor. Pra, çdo tremujor bëhet një raport mbi detyrimet e reja të krijuara, mbi detyrimet e vjetra të shlyera dhe stokun e mbetur. Që nga koha kur kemi filluar t’i monitorojmë, që në vitin 2015, këto detyrime kanë qenë 11,8 miliardë dhe aktualisht janë 6,8 miliardë. Pra, trendi është ulja, absolutisht rritja. Pra, krijohet borxh i ri, shlyhet nga i vjetri, por në neto ka reduktim të stokut të detyrimeve të njësive vendore.

Bashkë me njësitë vendore ne kemi një strategji tonën. Ata dërgojnë te ne një plan masash për ta shlyer këtë borxh brenda tre vjetëve, kurse ne e depozitojmë në degën e thesarit. Pra, kemi një metodologji shumë analitike për ta ndjekur dhe për t’i monitoruar njësitë vendore që borxhi vetëm të shlyhet!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, Moza! Merru me bonusin.

Jam i bindur që ke sjell bonus në akt ... Nëse nuk e ke sjellë, mos hajde fare! Kaq po të them. As ti, as ...

Po, zoti Roshi.

Artur Roshi – Zonja Lati, për sa i përket problemit të borxhit tatimor të bashkive, si mendoni ju, është krijuar nga pamundësia që ka biznesi për të paguar apo nga paaftësia e administratës tatimore, nga mungesa e burimeve njerëzore që kanë bashkitë në tërësi, siç doli në pah? Pra, nga pamundësia për ta paguar apo nga paaftësia për t’i mbledhur?

Arben Ahmetaj – Po, zonja Lati.

Lindita Milo (Lati) – Në fakt, unë do t’i quaja më shumë detyrime të prapambetura të bashkive sesa borxh tatimor. Absolutisht, ju keni shumë të drejtë në adresimin e pyetjes se si mund të përmirësohet, por ne përmendëm elementin e fondeve të bashkive, të cilat mund të trashëgohen për vitet e ardhshme dhe që ka një problem në mënyrën se si tërhiqen. Pra, në fund të vitit bashkive ju hiqet e drejta për të përdorur fondet e tyre si rezultat i një përplasjeje që kanë me bazën ligjore, ligji i buxhetit dhe ligji i vet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne themi se është mungesa e likuiditeteve, të cilat shkaktohen jo thjesht për efekt të mundësive, por për efekt të zbatimit të ligjit të buxhetit, i cili nuk i lejon që të përdorin ...

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Më fal, zoti Roshi! Meqë bëtë pyetjen e duhur, nuk besoj se është ashtu siç tha zonja Lati, në respektin tuaj, nuk ka lidhje me likuiditetet, sepse deficitin do të respektohet. Në qoftë se pushteti vendor do të kishte likuiditete, pse do të krijonte *arrears*? Nëse pushteti vendor do të kishte të ardhura ...

Tani, pas kaq kohësh, kur vendosen tavane për deficitin, se ka dhënë leje ndërtimi apo ka rritur të ardhurat dhe ka ...? Të mos planifikojë për vitin tjetër! Ka rregulla financiare. Mos planifiko rrugë të re, por shlyej detyrimet për rrugën e vjetër.

T'ia hedhësh procedurës së buxhetit, që është themeli i financave publike, me krijimin e *arrears* është planifikim i gabuar. Nëse ka 30 milionë dollarë më shumë, të mos bëj 30 milionë dollarë planifikime të reja, por të bëj 30 milionë dollarë shlyerje detyrimesh të vjetra. Të pastrojë llogarinë. Prandaj ju përmenda cilësinë e shpenzimeve dhe të planifikimit. Nuk diskutohet që kjo vlen edhe për ne, por edhe për qeverinë qendrore.

Mos hap investime të reja, por pastro 6,2 miliardë detyrime që ke.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

6,2, zëvendësministër. Jua them unë, sepse më del në ëndërr. Ka qenë 5,6 dhe ka shkuar 6,2.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jua kam thënë punonjësve të ministrisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E njëjta gjë është.

Faleminderit!

Artur Roshi - Meqenëse përmendët cilësinë e barnave (jam dakord që qeverisja është unike në funksionimin e saj), një nga auditimet është bërë mbi sistemin farmaceutik të barnave, kam një pyetje konfidenciale: Çfarë ju ka rënë në sy për cilësinë e barnave, sepse na intereson shumë?

Arben Ahmetaj – Është jashtë kontekstit, por ty të lejohet. E kemi thënë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kemi thënë. Çfarë ke? Faleminderit që e bërë pyetjen jashtë kontekstit!

Zonja Lati, jashtë kontekstit, mund të përgjigjeni.

Rigels Guzi – Meqenëse është një auditim performancë për të cilin ...

Arben Ahmetaj – Shiko çfarë instrumenti përdorën. Nuk u përgjigj zonja Lati, por u përgjigj

Rigels Guzi - Cilësia e barnave në sistemin farmaceutik është një auditim performancë. Ne kemi konstatuar disa problematika, të cilat i kemi bërë edhe publike. Më kryesorja është fakti që pranohen barna që janë afër afatit të skadencës. Gjithashtu, nuk ka një

sistem që t'i monitorojë barnat, sidomos në QSUT, se si përdoren dhe rrjedhimisht edhe për prognozatat e ardhshme. Përgjithësisht, inspektimi është i dobët.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Në respekt të kontrollit që keni bërë për sa u përket barnave dhe gjithë menaxhimit të fondit shëndetësor ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kuptova. Do të vij atje.

... do të duhet të shtoni një komponent, që do të marrë parasysh performancën siç e thatë specifikisht, sepse mungon në ato kontrole, të kohës së përdorimit të barnave, që nga planifikimi, prokurimi, nxjerrja jashtë rafteve për përdorim, përdorimi, kancelimi, asgjësimi. Një gjë tjetër që do të duhet të keni parasysh është edhe efektiviteti i ilaçeve. Për 1 lek në Maqedoni kjo aspirinë është e kësaj cilësie apo për 1 lek këtu është gjysma e kësaj cilësie. Është edhe kjo te performanca. Mund ta bëj procedurën super, por të kam dhënë ilaç që ty nuk të bën efektin e duhur, ndërkohë, për të njëjtin çmim kam një ilaç me dyfishin e fuqisë.

Faleminderit për pyetjet dhe komentet! Jeni shumë të mirë!

Kalojmë në procesin e votimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti do të bësh qëndrim. Më falni, e tërheq ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka kamera.

Artur Roshi - Përderisa buxheti është faktik, ne nuk kemi fuqi për të vepruar mbi të. Jam dakord në frymë me kryetarin që ne duhet të shikojmë buxhetin e shkuar për të parë se çfarë diskutimesh esenciale mund të bëjmë në shërbim të buxhetit të ardhshëm.

Ajo që bie në sy, meqenëse Kryeministrin e kemi piktor, është që tabloja e ekonomisë për vitin 2018, m'u duk si harta e Botiçelit, e frymëzuar nga harta e Ferrit e Dantes.

Në këndvështrimin tim, për sa i përket performancës së qeverisë, mjerë çfarë shikojmë dhe mjerë çfarë dëgjojmë. Nuk ka përputhje të asaj çfarë thuhet për rritjen ekonomike, dhe kjo nuk është thjesht perceptim, me efektin që ka te xhepat e shqiptarëve. Neve na intereson ana ekonomike. Vërtet unë thashë që pyetja për shëndetësinë është jashtë kontekstit, por, në fund të fundit, ekonomia është e lidhur me shëndetin e qytetarit. Kështu që, këto qëndrojnë në unison dhe nuk mund t'i ndajmë nga njëra – tjetra. Megjithatë, do të kemi mundësi për t'u shprehur në vazhdimësi. Vlerësoj më shumë projektbuxhetin e vitit që vjen sesa ata që ka kaluar.

Arben Ahmetaj - Një diskutim filozofik do ta bëjmë në komision edhe në prezencë të ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ty të ka kapur një gëzim i paparë, që nuk përputhet me rritjen ekonomike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të bëjmë edhe një diskutim filozofik, sepse zoti Roshi tha që shëndeti i qytetarëve futet te rritja ekonomike. Zhak Atali ka thënë se duhet parë cilësia e rritjes, nuk duhet parë shifra e rritjes. Po më habit dhe më vjen shumë keq që nuk kishte kamera!

Kalojmë në procesin e votimit.

Më mësoni si të veprojmë me votimin, sepse është hera e parë që duhet të votohet raporti. Do të votohet ligji?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vetëm ligji. Dakord.

Votojmë në parim draftligjin “Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2018”.

Pro? Kundër? 1 votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1.

Miratimi i raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2.

Hyrja në fuqi.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit!

Faleminderit Kontrollit të Lartë të Shtetit! I bëni të fala kryetarit nga mua!

Faleminderit Ministrisë së Financave dhe zëvendësministrit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duhet votuar në tërësi?

E votojmë ligjin në tërësi.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti